



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 401 Akti**

**Nr. 540 Vendimi**  
**Tiranë, më 10.6.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 8.6.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Enkela Vlora (Bajo)**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5, e nenit 179/ b, të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Firdes Shuli. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016,

---

<sup>1</sup>Raport dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2018.

si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Enkela F Vlora*.

7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 20.5.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht bazuar në tria kriteret e rivlerësimit, për subjektin e rivlerësimit Enkela Vlora dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, subjektit Enkela Vlora, i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Znj. Enkela Vlora, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datat 30.5.2022 dhe në datën 3.6.2022. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 6.6.2022.

13. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 8.6.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i

---

<sup>2</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. \*\*\*, datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, të KDZH-së.

<sup>3</sup>Raporti me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021.

rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

Subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;

- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Enkela Vlora, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

23. Subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora është bërë subjekt deklarues në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën 2003 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe edhe deklarata *Vetting*).

24. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; si dhe (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

#### **1. Apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, rruga “M. P”, Tiranë**

Pasuria apartament<sup>4</sup> me sip. 56 m<sup>2</sup> është në bashkëpronësi me prindërit me 1/3 pjesë takuese, përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me vlerë 4.042 lekë, deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 (në vijim DPV).

Subjekti për këtë pasuri ka deklaruar se në këtë apartament ka kryer një ndërtim shtesë, pa leje në vitin 1997, me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup>, e deklaruar nga babai për legalizim në datën 22.1.2015, procesi është në fazën e vetëdeklarimit dhe nuk është kryer asnjë pagesë për legalizim.

#### **1.1 Hetimi i Komisionit**

**ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana Veri**<sup>5</sup> ka informuar se shtetasja Enkela F Vlora ka të regjistruar pasurinë e llojit apartament me sip. 56 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me 2 prindërit.

<sup>4</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë për vërtetim pronësie datë 28.6.2005, të apartamentit me sip. 56 m<sup>2</sup>, e regjistruar në z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\* vol. \*, f. \*\*\*, adresa: rruga “M.P”, p. \*\*\*, shk. \*, k. \*, ap. \*\*, Tiranë, në emër të shtetasve F.B, L.B dhe Enkela Vlora; kontratë shitjeje datë 3.2.1994, me palë shitëse Ndërmarrja Komunal Banesa nr. \* dhe palë blerëse F.B, L.B dhe Enkela Vlora të apartamentit nr. \*\*, në rrugën “M.P”, Tiranë, e përbërë 1+1, me sip. 56 m<sup>2</sup>, ndërsa trualli rreth pallatit është 360 m<sup>2</sup> në vlerën 4.042 lekë; deklaratë nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2015, për përfshirjen e procedurave të legalizimit dhe ndërtimit pa leje, në emër të shtetasit F.B, datë 26.1.2015, i cili deklaron se ndërtimi është kryer në vitin 1997, në rrugën “M.P”, p. \*\*\*, apartament nr. \*\*, shk. nr. \*, Tiranë.

<sup>5</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2020.

ASIG<sup>6</sup> ka dërguar fotografime ajrore për intervalet kohore 2007 – 2008, 2015 – 2017 dhe 2018. Referuar fotografimeve duket shtesa e ndërtuar që në periudhën e fotografimit të parë në vitin 2007 dhe nuk ka ndryshime në kuotat e lartësisë së ndërtimit, në vitet në vijim.

ALUIZNI<sup>7</sup> ka informuar se shtetasi F. B ka aplikuar për legalizim e një ndërtimi informal me vendndodhje rruga “M.P”, Njësia Administrative Nr. \*, Tiranë, me deklaratën nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2015, ku rezultojnë dhe 4 fotografi të ndërtimit informal.

## 1.2 Analiza e fakteve

Referuar akteve të administruara rezulton një kontratë shitje, datë 3.2.1994, me palë shitëse Ndërmarrjen Komunale Banesa dhe palë blerëse F, L dhe Enkela Bajo, për apartamentin me nr. \*\*, në adresën rruga “M.P”, Tiranë, e përberë 1+1, me sip. 56 m<sup>2</sup>, i blerë në shumën 4.042 lekë.

Sipas deklaratës së depozituar pranë ALUIZNI-t në datën 26.1.2015, për përfshirje në procedurat e legalizimit, aplikuesi (babai i subjektit) ka deklaruar se ndërtimi është kryer në vitin 1997. Në këtë formular nuk është saktësuar sipërfaqja e shtesës. Subjekti ka shpjeguar<sup>8</sup> se procedura e legalizimit të kësaj shtese ende nuk ka përfunduar dhe nuk është lëshuar një leje legalizimi për këtë shtesë.

Për ndërtimin e shtesës, subjekti ka shpjeguar<sup>9</sup> se: *“Në vitin 1997, nisur nga nevojat e mëdha për zgjerim të banorëve të pallatit është bërë shtesë anësore (nga i pari tek i pesti) në kushtet e një ndërtimi informal. Shtesa ka kushtuar rreth 100.000 lekë, për të cilën nuk disponojmë asnjë dokument në kushtet e kalimit të një kohe shumë të gjatë dhe të mënyrës së ndërtimit dhe informalitetit të kohës”.*

Më tej, subjekti ka shpjeguar<sup>10</sup> se: *“Shtesa është krijuar me të ardhura nga pagat e anëtareve të familjes B në vite deri në 1997 dhe më konkretisht paga ime, e nënës dhe e babait tim/jo e motrës sime”.*

## 1.3 Analiza financiare

Komisioni analizoi mundësinë e ndërtimit të shtesës duke marrë në konsideratë:

- koston e ndërtimit të shtesës, sipas çmimit të Entit Kombëtar të Banesave për vitin 1997<sup>11</sup>, në shumën 16.567 lekë/m<sup>2</sup> dhe vlerën e ndërtimit të shtesës me sip. 6 m<sup>2</sup>, që kanë rezultuar në shumën 99.402 lekë, e cila përputhet me deklaratimet e subjektit për vlerën e shpenzuar;
- vlerën e mobilimit të shtesës në shumën 10.000 lekë, e cila iu shtua vlerës totale të investimit;
- të ardhurat e subjektit, nënës dhe babait për periudhën deri në vitin 1997.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar një balancë negative në shumën 87.929 lekë. Në lidhje me balancën negative, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

<sup>6</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2022.

<sup>7</sup>E-mail datë 6.11.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>8</sup>Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022.

<sup>9</sup>Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2022.

<sup>10</sup>Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022.

<sup>11</sup>Sipas vendimit nr. \*\*, datë 5.1.1998, të EKB-së.

## 1.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në prapësimet e depozituara, ka shpjeguar se investimi i kryer mund të mbulohej me të ardhurat e krijuara nga punësimi, për periudhën 1994 – 1997, dhe referuar dokumentacionit të depozituar, ka qenë e punësuar që në vitin 1995<sup>12</sup> si ndihmës gjyqtare.

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se Komisioni ka analizuar të ardhurat familjare vetëm për vitin 1997, ndërkohë që familja e tyre nuk ishte një familje e re, e krijuar rishtazi, por ishte krijuar shumë vite më parë dhe ka pasur një rezervë ekonomike të mjaftueshme për të bërë një investim në këtë shumë.

## 1.5 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin shkresor të administruar në dosje, vlerësoi të drejtë pretendimin e subjektit se analiza financiare duhet të shtrihej vite më parë, në lidhje me investimin në shtesën anësore me sip. 6 m<sup>2</sup>. Duke përllogaritur të ardhurat e ligjshme të familjes B, për periudhën 1994 – 1997, analiza financiare ka rezultuar me balancë pozitive. Përfundimisht, u provuan burimet e ligjshme financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës me sip. 6 m<sup>2</sup>.

## 2. Automjet tip “Volkswagen Passat”<sup>13</sup>, me vlerë 300.000 lekë

Pasuria automjet është blerë në datën 23.5.2015, në shumën 300.000 lekë, me vit prodhimi 1999, me burim të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të mëparshëm në datën 5.5.2015, për vlerën 300.000 lekë.

### 2.1 Hetimi i Komisionit

**DPSHTRR-ja**<sup>14</sup> ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit ka në pronësi mjetin me targa AA \*\*\* LY. Sipas kontratës së shitblerjes nr.\*\*\*, datë 23.5.2015, me palë shitëse N.B dhe palë blerëse Q.V, është blerë automjeti tip “Volkswagen Passat”, në vlerën 300.000 lekë.

Nga aktet e dosjes rezulton se shitësi i këtij automjeti është vëllai i subjektit, z. N.B, i cili e ka blerë këtë automjet në datën 24.3.2009, në shumën 6.000 USD.

**AMF-ja** informon se shtetasi N.B, për herë të parë, në vitet 2011-2012, ka blerë polica sigurimi, ku evidentohet si përdoruese subjekti dhe bashkëshorti. Referuar te dhënave të këtij sistemi nga viti 2015 e në vijim, kur automjeti është blerë nga Q.V (bashkëshorti i subjektit), policat e sigurimit janë vetëm në emër të tij.

Bashkëshorti i subjektit e disponon ende automjetin tip “V.P” dhe figuron si pronar e përdorues.

<sup>12</sup>Sipas vendimit nr. 1, datë 30.3.1995, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku është emëruar ndihmës gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>13</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 23.5.2015, me palë shitëse N.B dhe palë blerëse Q. V, të automjetit tip “V.P”, me targa TR \*\*\* S, në vlerën 300.000 lekë. Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor, sipas së cilës rezulton se targa ka ndryshuar AA \*\*\* LY, në emër të shtetasit Q.V, me të njëjtin numër shasie; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 5.5.2015, me palë shitëse Enkela Vlora dhe palë blerëse A.I, të automjetit tip “AUDI”, me targa TR \*\*\* J, në vlerën 300.000 lekë.

<sup>14</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2020.

## 2.2 Burimi i krijimit

Në lidhje me burimin, subjekti ka deklaruar se për blerjen e automjetit tip “V.P” ka përdor të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “AUDI”, që ka pasur në pronësi dhe e ka shitur në datën 5.5.2015. Referuar akteve, ky mjet është shitur përpara se të blihej automjeti tip “V. P”, pra, rezulton se ka shërbyer si burim për blerjen e këtij automjeti.

Nga verifikimi i kryer në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar blerjen e mjetit tip “AUDI”, me targa TR \*\*\* J, në datën 1.4.2004, në shumën 460.000 lekë. Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja ka rezultuar se në kontratën e shitblerjes së automjetit tip “AUDI”, nr. \*\*\*, datë 1.4.2004, çmimi i blerjes është në shumën 200.000 lekë.

Lidhur me mospërputhjen e çmimit, subjekti ka shpjeguar<sup>15</sup> se: “... çmimi i pasqyruar në kontratën e datës 1.4.2004, prej 200.000 lekësh është çmimi i dhënë shitësit, ndërkohë që në vlerën prej 460.000 lekësh unë në deklarinimin e bërë kam përfshirë të gjithë shpenzimet e bëra për automjetin e blerë, si taksa doganore në vlerën 154.619 lekë, taksat e qarkullimit të automjetit, shpenzimet noteriale (të kontratës), taksë regjistrimi, taksë shitje, siguracion i mjetit, si dhe disa shërbime/servis të bëra mjetit, të nevojshme si mjet i përdorur. Të gjitha këto në kohën e deklarinimit kishin kapur vlerën 460.000 lekë. Duhet të theksojmë se në kohën e deklarinimit në vitin 2005 nuk është kërkuar dokumentacion, sot nuk disponoj”.

Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit tip “AUDI”, blerë në vitin 2004, subjekti ka shpjeguar<sup>16</sup> se: “Janë të ardhurat nga pagat e mia në vitin 2003 dhe fillimi i vitit 2004, të dhëna të cilat ju i dispononi. Këtu duhet të theksojmë se në kushtet e një deklarinimi të parë të bërë për vitin 2003 në datën 15.3.2004, nuk ka qenë aspak e qartë që duhet të kishim deklaruar mbetjet cash të vitit të mëparshëm nga paga, e cila ishte e ardhur zyrtare e deklaruar, pra, ajo çfarë kishte mbetur nga pagat e vitit 2003. Sipas nenit 21, të ligjit të kohës nr. 9049/2003, deklaruesit duhet t’i jepeshin të gjithë këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës, fakt i cili nuk është realizuar në atë kohë. Kjo situatë është paraqitur problematike dhe në vitet në vijim nga një pjesë e trupës gjyqësore”.

## 2.3 Analiza financiare

Referuar dokumentacionit të administruar, subjekti ka pasur mundësi të blejë automjetin tip “V.P” në datën 23.5.2015, me çmim 300.000 lekë, pasi si burim ka shërbyer shuma e siguruar nga shitja e automjetit tip “AUDI”, në shumë 300.000 lekë, në datën 5.5.2015, pra, rezulton me të njëjtin çmim.

## 3. Automjet tip “AUDI”, datë 1.4.2004

Komisioni analizoi edhe burimet e ligjshme për blerjen e këtij automjeti dhe për efekt të analizës financiare, si çmimi i blerjes së automjetit është marrë vlera e deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2004, në shumën 460.000 lekë. Subjekti, në DPV-në e vitit 2004, nuk ka deklaruar burim krijimi për blerjen e automjetit. Në DPV-në e vitit 2003, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Nisur nga ky fakt, në analizën financiare, u analizuan vetëm të ardhurat *neto* dhe shpenzimet e subjektit, për periudhën janar-mars 2004, sikurse paraqiten në tabelën vijuese. Nga dokumentacioni i depozituar për këtë periudhë, nuk provohen të ardhura të tjera

<sup>15</sup>Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022.

<sup>16</sup>Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022.



përveç pagës së subjektit. Në lidhje me shpenzimet, ato janë përlogaritur për katër persona<sup>17</sup> sipas standardit të ILDKPKI-së.

Nga analiza e kryer mbi mundësitë për blerjen e automjetit tip “AUDI”, ka rezultuar një balancë negative në shumën 363.874 lekë, mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “AUDI”, në datë 1.4.2004. Në lidhje me balancën negative, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të Nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

### **3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni, për periudhën 2000 – 2010**

Subjekti nga momenti i emërimit në detyrën e gjyqtares në vitin 2000 deri në korrik të vitit 2010 (martuar), ka jetuar me familjen e origjinës. Nisur nga ky fakt, është bërë hetim mbi pasuritë e personave të lidhur bazuar në certifikatën familjare, nga ku ka rezultuar, si vijon:

**4. Automjet tip “V.P”**, i blerë nga vëllai i subjektit, z. N.B, në shumën 6.000 USD, në mars të vitit 2009

**DPSHTRr-ja**<sup>18</sup> ka informuar se vëllai i subjektit (N.B) ka pasur të regjistruar mjetin tip “V. P”, me vit prodhimi 1999. Nga aktet e dosjes, rezulton se z. N.B, e ka blerë këtë automjet në datën 24.3.2009, në shumën 6.000 USD. Ky mjet iu shit në vitin 2015 bashkëshortit të subjektit Q.V, në shumën 300.000 lekë.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtij automjeti, subjekti ka shpjeguar se mjeti tip “V. P”, me vlerë 6.000 USD është blerë me kontributin e përbashkët, pjesërisht të subjektit në masën 2.975 USD dhe motrës (e cila banon familjarisht në Zvicër).

#### **4.1 Analiza financiare**

Referuar shpjegimeve, rezulton se subjekti ka investuar në blerjen e automjetit të vëllait N. B në mars të vitit 2009. Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit, rezulton se deklarimi përputhet me tërheqjen nga llogaria bankare në “Raiffeisen Bank”, në datën 23.3.2009, në shumën 2.975 USD. Për shumat e sjella nga e motra A.L, si kontribut për blerjen e automjetit të vëllain, subjekti nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës.

Analiza financiare mbi mundësitë për blerjen e automjetit tip “V.P”, në shumë 6.000 USD (e konvertuar në shumën 563.880 lekë, me kursin e këmbimit të vitit 2009), në emër të vëllait të subjektit, ka rezultuar balancë negative në shumën 205.537, për vitin 2009.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit Kushtetutës.

#### **4.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

i. Në lidhje me balancë negative në shumën 363.874 lekë, që ka rezultuar për blerjen e automjetit tip “AUDI”, në datën 1.4.2004, subjekti ka pretenduar se ka disponuar gjendje *cash* nga kursime të një viti më parë, por ka pasaktësi në deklarimin e likuiditeteve në fund të vitit 2003 dhe se këto tepricat likuiditetesh janë përdorur për të mbuluar këtë investim. Subjekti ka

---

<sup>17</sup>Pasi sipas akteve rezulton se e motra e subjektit ka lidhur martesë në dhjetor të vitit 2002 dhe larguar nga familja në janar të vitit 2003.

<sup>18</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2022.

pretenduar se nuk ka pasur dijeni dhe as është trajnuar për të deklaruar saktë gjendjen e likuiditeteve në fund të vitit.

ii. Në lidhje me gjendjen negative, për automjetin tip “V.P”, në vitin 2009, subjekti ka pretenduar se i vëllai në kuptim të ligjit nr. 84/2016, nuk është person i lidhur dhe as person tjetër i lidhur, pasi N.B është ndarë nga përbërja familjare/certifikata familjare në datën 24.7.2008 (është paraqitur dokumentacion) dhe në këtë kontekst në kohën e blerjes prej tij të automjetit në datën 24.3.2009, ai nuk bën pjesë në rrethin e personave të lidhur.

Gjithashtu, shtetasi N.B, nuk ka cilësinë e huamarrësit, huadhënësit, dhuruesit, të ndonjë pasurie, që të lidhet me subjektin e rivlerësimit Enkela Vlora dhe as nuk është person tjetër i lidhur, bazuar në pikat 13 dhe 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë kontekst nuk mund të bëhet fjalë për mungesë burimesh të ligjshme të tij në cilësinë e personit të lidhur dhe me efekte balance negative për subjektin e rivlerësimi në vlerën 205,537 lekë.

Në kushtet e mësipërme nuk është paraqitur dokumentacion i mëtijshëm për shumat e sjella nga e motra A.L, si kontribut për blerjen e automjetit të vëllait. Kontributi i dhënë nga motra nuk vjen si kontribut në favorin e subjektit të rivlerësimi, por të vëllait.

Subjekti ka pretenduar se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar sjelljen e shumave nga motra e saj, për të mbuluar pjesërisht blerjen e automjetit në emër të vëllait, pasi ka kaluar një periudhë e gjatë kohore.

Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar:

- deklaratë nr. \*\*\*, datës 26.5.2022, nga shtetasi S.L, burri i motrës së subjektit, i cili referon se familja e tij ka dhënë shumën 3.000 USD, për N.B, për blerjen e automjetit tip “V.P”, në vitin 2009;
- vërtetim nga regjistri i shoqërisë “T.A”, ku shtetasi S.L(kunati) paraqitet si një nga ortakët dhe president i bordit të drejtorëve, shoqëria ka datë regjistrimi 4.12.2009 dhe kapital themeltar krijimi në vlerën 100.000 franga;
- transaksion financiar për blerje pasurie në shkurt të vitit 2009, në shtetin zviceran.

Subjekti ka shpjeguar se nga provat e mësipërme vërtetohet gjendja shumë e mirë financiare e familjes së motrës përgjatë vitit 2009 (para dhe pas muajit mars të vitit 2009) të blerjes së automjetit/dhe mundësia reale për të kontribuar për vëllain në vlerën 3000 USD, lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të tilla janë të kontrolluara nga shteti, sidomos bëhet fjalë për një shtet të tillë si Zvicra. Shumat nuk janë sjellë në atë kohë me transfertë bankare. Motra, për vetë gjendjen e saj ekonomike, ka ndihmuar në vijimësi edhe prindërit me vlera monetare. Subjekti ka shpjeguar se për vitin 2009 ka deklaruar pakësim pasurie në deklaratën periodike vjetore.

#### **4.3 Vlerësimi i Komisionit**

Pas prapësimeve, subjekti nuk depozitoi dokumentacion provues për të justifikuar:

- balancën negative në shumën 363.874 lekë, për blerjen e automjetit tip “AUDI”, në vitin 2004; si dhe
- balancën negative në shumën 205,537 lekë, për blerjen e automjetin tip “V.P”, në vitin 2009.

Në lidhje me argumentin e subjektit se mungesa e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit tip “AUDI”, ka ardhur për shkak të pasaktësisë në deklarimin, pra, lidhet me mosdeklarimin e likuiditeteve në fund të vitit 2003, të cilat janë përdorur si burim për të mbuluar këtë shpenzim, nuk mund të pranohet nga Komisioni. Ky qëndrim i Komisionit vjen në përputhje edhe me standardin tashmë të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në raste të tilla. Përfundimisht, konstatimi për mungesë të burimeve të ligjshme për dy automjetet mbetet i njëjtë.

Në lidhje me konstatimin sa më sipër, i cili mund të ketë ardhur për shkak të pasaktësisë në deklarim të subjektit në raport edhe me deklarimet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, përfundimisht u konkludua se këto konstatime, si një shkak i vetëm dhe i veçantë, nuk janë të mjaftueshme për t’u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm dhe që mund të çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## 5. Llogari page në “Credins Bank”<sup>19</sup>, në emër të subjektit Enkela (B) Vlova

Nga verifikimi i të dhënave bankare nuk u verifikuan problematika.

## PASURI TË BASHKËSHORTIT TË REGJISTRUARA VEÇMAS

### 6. Apartament banimi<sup>20</sup> me sipërfaqe 103.4 m<sup>2</sup> + 48.9 m<sup>2</sup> verandë, ndërtim informal/shtesë në godinë ekzistuese, ndërtim *dublex* në katin e katërt dhe të pestë, në rrugën “B.R”, Tiranë

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2020.

<sup>20</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën:

kontratë shitjeje datë 7.2.1994 me palë shitëse Ndërmarrja Komunal Banesa nr. \* dhe palë blerëse F.K, A.V dhe Q.V, të apartamentit nr. \* në rrugën “B.R”, Tiranë, në katin e katërt, e përbërë 1+1 me sip. 53 m<sup>2</sup>, ndërsa trualli rreth pallatit është 236 m<sup>2</sup>, në vlerën 4.003 lekë; vërtetim nr. \*\*\*, datë 10.3.1994, në emër të shtetasve F.K, A.V dhe Q.V; vetëdeklarim datë 24.11.2006, për legalizimin e shtesës anësore + papafingo në emër të shtetasve F(e) K, në rrugën “B.R”, p. \*\*, shk.\* ap. \*, me sipërfaqe sheshi 88 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi 88 m<sup>2</sup>; vendim nr. \*\*\*, datë 25.9.2008, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkues Q.V, në të cilën u vendos se pas vdekjes së F.V, trashëgimorë ligjore janë A.V dhe Q.V; kontratë e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. \*\*\*, datë 10.10.2011, me palë shitëse Agjencia e Legalizimit, Integritit dhe Urbanizimit të Zonave/Ndërtimore Informale dhe palë blerëse A.T, Z.Sh, F.Ç, Q.V dhe A.V, të parcelës ndërtimore me sip. 36 m<sup>2</sup>. Mandatpagesë datë 31.3.2009, në “Credins Bank” në shumën 151.497 lekë. Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukture është 150.497 lekë, për objektin sh. anësore + sh. kati pranë pallatit nr. \*\*. Mandatpagesë, në “Credins Bank” në shumën 49.000 lekë. Vlera e parcelës ndërtimore është 48.000 lekë për objektin shtesë anësore, pranë pallatit nr. \*\*. GenPlan. Kopje ID-ve; prokurë e përgjithshme nr. \*\*\*, datë 29.4.2011, A.V e cila emëron si përfaqësues ligjor vëllain e saj Q.V, ta përfaqësojë me të drejtat plota në të gjitha institucionet publike; tabelë përmbledhëse nga ALUIZNI Tirana nr. \*. Kartelë e pasurisë në z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\* vol. \*, f. \*\*, me sip. 36 m<sup>2</sup>, në emër të bashkëpronareve A.T, Z.Sh, F.Ç, Q.V dhe A.V. Shuma e paguar 241.982 lekë, me përshkrimin e veçantë “shtesë anësore 4 kate dhe shtesë kati, objektin ekzistues 4 kate dhe verandë 48.9 m<sup>2</sup>; Plan rivelim, prona e bashkëpronareve “V” me sip. 103.4 m<sup>2</sup>; leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 21.2.2013, shtesë anësore 4 kate dhe shtesë kati, në objekt ekzistues 4 kate, i jepet shtetasve A.T, Z.Sh, F.C, Q.V dhe A.V, në z. k. \*\*\* nr. pasurie \*\*\*, +\*\*, +\*-, +\*-\* \*\*, me sip. ndërtimore 36 m<sup>2</sup>, sip. e ndërtimit 51 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale 199.6; 51 m<sup>2</sup> katër kat +1kat dhe 48.9 m<sup>2</sup>, verandë; kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 27.12.2013, me palë të parë A.V dhe palë të dytë Q.V. Palët bien dakord që të shkëmbejnë pjesët e tyre në pasuritë e përbashkëta dhe A.V të përfitojë apartamentin me nr. pasurie \*\*\* ZK\*\*\*, vol. \*, f. \*\*, me sip. 53 m<sup>2</sup>, në rrugën “B. R”, Tiranë. Pala e dytë Q.V përfiton nga shkëmbimi shtesë kati në objektin ekzistues 4 kate, me sip. ndërtimi 51 m<sup>2</sup> dhe verandë 48.9 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\* në rrugën “B.R”, Tiranë dhe pasurinë apartament nr. \*, në shtesë anësore me sip. 52.4 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\* m<sup>2</sup>, në rrugën “B.R” Tiranë; vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 24.5.2013, në emër të shtetasve A.V dhe Q.V të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 51 m<sup>2</sup>, në shtesën anësore dhe sip. verandë 48.9 m<sup>2</sup>, dhënë me leje legalizimi. Harta –treguese; vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 24.5.2013, në emër të A.V dhe Q.V të pasurisë \*\*\*, ZK\*\*\* me sip. 52,4 m<sup>2</sup>, apartament nr. \*, në shtesën anësore dhënë me leje legalizimi. Harta treguese; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 6.8.2013, në emër të A.V dhe Q.V, të pasurisë nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*, vol. \*, f. \*\*, apartament me sip. 53 m<sup>2</sup>, në rrugën “B.R”, Tiranë; vërtetim dokument hipotekor, nr. \*\*\*, datë 26.2.2014, në emër të shtetasit Q.V, të pasurisë nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, me sip. 52.4 m<sup>2</sup>, apartament nr. \*, në shtesën, në objektin ekzistues 4 kate, me sip. 52.4 m<sup>2</sup>, në rrugën “B.R”, Tiranë. Harta treguese. Vërtetim dokument hipotekor, nr. \*\*\*, datë 26.2.2014, në emër të shtetasit Q.V, të pasurisë nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, me sip. 51 m<sup>2</sup>, apartament nr. \*, në shtesën anësore në objektin ekzistues 4 kate, me sip. ndërtimi 51 m<sup>2</sup>, në rrugën “B.R”, Tiranë. Harta treguese; vërtetim dokument hipotekor, nr. \*\*, datë 15.1.2016, në emër të shtetasit Q.V, të pasurisë nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\* me sip.103.4 m<sup>2</sup>, apartament *dublex* në katin e katërt dhe të pestë me sip. 103.4 m<sup>2</sup>, në rrugën “B. R”, Tiranë. Harta treguese; vendim nr. \*\*\* prot., datë 1.5.1996, nga Komisioni i Kthimit të Pronave, të truallit me sip. 600 m<sup>2</sup>, në lagjen “V”, Vlorë, në emër të shtetasit Q e Sh.K. Vërtetim pronësie; dëshmi trashëgimie, datë 30.6.1993, pas vdekjes së

Sipas formularit të vetëdeklarimit të datës 24.11.2006, kjo pasuri është ndërtuar në vitet 2003 – 2006. Pjesa takuese: 100% në pronësi të bashkëshortit të subjektit. Pasuri e krijuar para martesës së subjektit. Si burim krijimi janë deklaruar kryesisht me të ardhurat nga nëna e bashkëshortit dhe me të ardhurat e bashkëshortit dhe motrës së tij. Në deklarimin e parë të bashkëshortit në DPV-në e vitit 2010 ka deklaruar apartamentin me sipërfaqe rreth 140 m<sup>2</sup>, në proces legalizimi, ndërtuar me të ardhurat e nënës nga shitja e pronave. Ndërtim informal i legalizuar më 21.2.2013, nga ALUIZNI.

### 6.1 Hetimi i Komisionit

**ASHK-ja Drejtoria vendore Tirana - Jug**<sup>21</sup> ka konfirmuar se shtetasi Q.V ka të regjistruar pasurinë apartament me sip. 103.4 m<sup>2</sup>, të regjistruar në datën 29.5.2013.

**ASHK-ja Njësia e Kadastrës dhe hartografisë**<sup>22</sup> ka konfirmuar se nga verifikimi në bazën qendrore të të dhënave të vetëdeklarimit shtetasit Q dhe A.V rezultojnë aplikues për proces legalizimi.

**ALUIZNI**<sup>23</sup> ka bashkëlidhur leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 21.2.2013, shtesë anësore 4 kate dhe shtesë kati, në objekt ekzistues 4 kate, në emër të shtetasve Q dhe A.V, me sip. parcele 36 m<sup>2</sup>, me sip. 51 m<sup>2</sup> kati katërt +1 kat 52 m<sup>2</sup> dhe 48.9 m<sup>2</sup>, verandë.

**ASIG**<sup>24</sup> ka informuar se zotëron fotografime ajrore, për intervalin kohor 2007 – 2008. Referuar kuotave të lartësisë në pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, rezulton se në vitin 2007, ka kuota në lartësi që indikojnë se shtesa ekzistonte është ngritur në periudhën e fotografimit në vitin 2007.

**ASIG**<sup>25</sup> ka depozituar fotografime ajrore të pasurive me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, të viteve 2007, 2015 dhe 2018. Referuar këtyre fotografimeve rezulton se në fotografimin e vitit 2007, pasuria nr. \*\*\*, ka kuota lartësie maximale 107.2, ndërkohë pasuria me nr. nr. \*\*\* (veranda) ka kuota lartësie 103.1 (veranda).

Në vijim, nga *ortofotot* në vitet 2015 dhe 2018, rezulton se kuotat e lartësisë për të dyja pasuritë janë 107 dhe tjetra 106, pra, edhe veranda rezulton që është mbyllur/ mbuluar duke u bërë pjesë e banueshme e apartamentit.

### 6.2 Analiza e fakteve

Nga aktet e dosjes rezulton se shtetasi Q.V, nëna F.K dhe motra A.V kanë nënshkruar kontratën e shitjes, datë 7.2.1994, me palë shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa Nr. \*, për blerjen/privatizimin e apartamentit me sip. 53 m<sup>2</sup>, nr. \*, rruga “B.R”, Tiranë.

---

shtetasve B.K dhe G.K, një nga trashëgimtarët ligjorë është dhe F.K; dëshmi trashëgimie nr. \*\*, datë 16.3.1994; kontratë shitje (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, datë 12.6.1998, me palë shitëse, trashëgimtarët “K” dhe palë blerëse L.Sh, truallin me sip. 28 m<sup>2</sup>, në Vlorë, në vlerën 280.000 lekë; kontratë shitjeje (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, datë 26.6.1998, me palë shitëse trashëgimtarët “K” dhe palë blerëse L.Sh, truallin me sip. 5.2 m<sup>2</sup>, në Vlorë, në vlerën 10.000 lekë/ m<sup>2</sup>; aktmarrëveshje datë 13.5.1999, me palë shitëse R.K dhe palë blerëse H.N. R.K në cilësinë e përfaqësuesit të posaçëm të trashëgimtarëve të shtetasit Q.K, i shet apartamentin 2+1 në katin e tretë të pallatit, që po ndërtohej nga shoqëria “N”, në truallin e trashëgimtareve të Q. K. Vlera e shitjes është 3.000.000 lekë; Deklaratë për heqje barre hipotekore nr. \*\*\*, datë 28.1.2004, të përfaqësuesve B. K, R.K, të cilët në datën 30.12.2003, me shoqërinë “A” sh.p.k kanë redaktuar kontratën e hipotekimit të truallit me sip. 462 m<sup>2</sup>, në Vlorë, në z. k. \*\*\*, mbi të cilin është ndërtuar një objekt 8 kate. Pronarët e truallit kanë përfituar vlerën 26.700.000 lekë, duke e kaluar pronësinë e truallit, tërësisht në favor të objektit që është ndërtuar.

<sup>21</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2020.

<sup>22</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.8.2020.

<sup>23</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.8.2020.

<sup>24</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2022.

<sup>25</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2022.

Në aktet e dosjes rezulton "Formular vetëdeklarimi për legalizimin e shtesës anësore + papafingo", datë 24.11.2006", në emër të shtetasës F.K.<sup>26</sup>, sipas së cilit vetëdeklarohet ndërtimi informal i ndodhur në rrugën "B.R", p. \*\*, shk.\* ap. \*, me sip. sheshi 88 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi 88 m<sup>2</sup>, me investitor F.K, ku cilësohet se gjendja faktike e ndërtimit është e përfunduar. Në dosjen e ALUIZNI-t rezulton certifikata familjare e datës 20.2.2006, e aplikueses F.K, e cila ka në përbërje të saj edhe 2 fëmijët madhorë Q dhe A.V.

Me vendim nr. \*\*\*, datë 25.9.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerën F.K (ndërruar jetë më 15.1.2007), në të cilën u vendos se trashëgimtarët e saj ligjorë janë fëmijët e saj A dhe Q.V.

Procedurat e legalizimit të ndërtimit informal kanë vijuar nga trashëgimtarët ligjor të aplikueses. Me kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore, datë 10.10.2011, me palë shitëse Agjencia e Legalizimit, Integritit dhe Urbanizimit të Zonave Ndërtimore Informale dhe palë blerëse Q dhe A.V dhe 3 banorë të tjerë, të cilët kanë blerë parcelën ndërtimore me sip. 36 m<sup>2</sup>.

Bashkëlidhur rezulton leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 21.2.2013, për shtesë anësore \* kate dhe shtesë kati, në objekt ekzistues 4 kate, i jepet 3 familjeve të pallatit dhe Q e A. V, me sip. ndërtimore 36 m<sup>2</sup>, sip. e ndërtimit 51 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale 199.6m<sup>2</sup>; 51 m<sup>2</sup> kati katër +1kat shtesë dhe 48.9 m<sup>2</sup>, verandë.

Me kontratën e shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 27.12.2013, me palë të parë A.V dhe palë të dytë Q. V, kanë rënë dakord që të shkëmbejnë pjesët e tyre në pasuritë e përbashkëta dhe A.V të regjistrojë në emër të saj apartamentin e fituar nga privatizimi i banesave shtetërorë dhe pala e dytë Q.V, përfiton nga shkëmbimi, të gjithë shtesën e katit në objektin ekzistues me sip. ndërtimi 52 m<sup>2</sup> + 52 m<sup>2</sup> dhe verandë 48.9 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\*, rruga "B.R" Tiranë.

### **6.3 Burimi i krijimit**

Në lidhje me burimin e krijimit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se shtëpia është ndërtim informal, në të dy katet, ndërtuar tërësisht para martesës së tij me subjektin e rivlerësimit. Sipas certifikatës së martesës<sup>27</sup> ka rezultuar se subjekti ka lidhur martesë në datën 12.7.2010, me bashkëshortin Q.V.

Në deklaratën *Vetting*, sipas shtojcës 2, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie: të ardhurat e nënës, si dhe kontributi i tij dhe i motrës me të ardhurat nga puna. Në deklarimin periodik vjetor të vitit 2010 si burim janë deklaruar të ardhurat e nënës së bashkëshortit F.K, nga pronat e trashëguara me ligjin përkatës.

Referuar akteve, formulari i vetëdeklarimit për legalizimin të shtesës është i datës 24.11.2006, dhe është nënshkruar nga aplikuesja F.K, e cila ka ndërruar jetë para përfundimit të procedurës së legalizimit, të cilat janë vijuar në emrin e bashkëshortit të subjektit dhe të motrës së tij, si të vetmit trashëgimtar ligjorë.

Subjekti, e pyetur nga Komisioni, në lidhje me burimet e ligjshëm, ka shpjeguar se: "Të ardhurat e familjes Vlora për krijimin e kësaj pasurie janë kryesisht nga të ardhurat e nënës

<sup>26</sup>Vjehra e subjektit.

<sup>27</sup>Depozituar në përgjigje të pyetësorit të tretë ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022.

së bashkëshortit, F.K, e cila ka qenë një nga trashëgimtarët ligjorë të Q.K/ ish-pronar/ pronat e të cilit janë trajtuar (njohje dhe kthime) me ligjin nr. 7698/1993.

Në vijim trashëgimtarët e Q. K kanë hyrë në transaksione/marrëdhënie juridike me të tretë duke tjetërsuar-shitur prona/ pjesë të tyre dhe përfituar të ardhura. Dhe vetë bashkëshorti Q. V ka dhënë kontribut pasi ka qenë tërë kohën në marrëdhënie pune, nga viti 1991 e në vazhdim...”.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë shumën konkrete të përfituar nga nëna e bashkëshortit nga shitjet e pasurive të paluajtshme (pasi kanë rezultuar disa trashëgimtarë), të trashëguara nga babai i saj.

#### **A. Të ardhurat e nënës për ndërtimin e apartamentit shtesë**

Subjekti ka shpjeguar<sup>28</sup> se: “Referuar aktit të dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit Q. K, pjesa takuese e F.K në pasuritë e Q.K është në masën 1/7 pjesë dhe në këtë raport ajo ka përfituar nga pasuritë e të atit.

Disa nga pronat kanë qenë në bashkëpronësi të Q.K dhe vëllait të tij Sh.K, në pjesë të barabarta nga 1/2 secili, gjë që do të thotë se në këto prona pjesa takuese e F.K është në masën 1/14 pjesë”.

Në lidhje me aktet e risjella nga subjekti në cilësinë e provës për të provuar burimet e ligjshme të të ndjerës F.K, si të përfituara nga pronat rezulton se:

- Akti “deklaratë për heqje barre hipotekore” nr. \*\*\*, datë 28.1.2004, është një veprim juridik i njëanshëm, lëshuar nga trashëgimtarët e shtetasve Q dhe Sh.K për heqjen e një barre hipotekore vendosur mbi një pasuri të paluajtshme, për shkak se këta trashëgimtarë i kanë dhënë një truall me sip. 462 m<sup>2</sup> shoqërisë “A” sh.p.k., për ndërtim objekti 8-katësh dhe bodrum.

Referuar këtij akti duket se për sipërfaqen e dhënë për ndërtim, vlera takuese e pronarëve të truallit në ndërtimin që do të bëhej ishte 19% dhe pronarët e truallit në këmbim të tokës së dhënë kanë përfituar shumën 26.700.000 lekë. Me përmbushjen e detyrimit nga shoqëria, bashkëpronarët kanë kërkuar të hiqet barra hipotekore mbi pasurinë.

Nuk ka asnjë provë apo gjurmim të pagesës së bërë nga shoqëria “A” sh.p.k., për pronarët e truallit, megjithëse sipas akteve shuma është e konsiderueshme në masën 26.700.000 lekë.

Subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është marrë *cash* dhe përdorur për ndërtimin e shtesës apartament *dublex*. Është e paqartë se si është paguar *cash* kjo shumë nga shoqëria pronarëve të truallit, pa u shoqëruar me një mandatarkëtim të thjeshtë apo një dokument mbështetës, ku të nënshkruanin të dyja palët.

Komisioni arsyeton se “deklarata për heqje barre hipotekore”, depozituar nga subjekti, i ka shërbyer shoqërisë për të hequr barrën hipotekore nga pasuria dhe për të vijuar me regjistrimin e saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Por, për efekt të provimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave, subjekti duhet të depozitonte dokumentacion, ku të provoheshin pagesat e përfituara dhe të provohej transferimi i pronësisë nga pronarët te shoqëria “A” sh.p.k.

---

<sup>28</sup>Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022.

Për efekt të analizës financiare, shumat e pretenduara si të përfituara nga e ndjera F.K sipas aktit “deklaratë për heqje barre hipotekore” nr. \*\*\*, datë 28.1.2004, nuk janë reflektuar në analizën financiare si burime të ligjshme.

- Me aktmarrëveshjen e datës 13.5.1999 mes R.K/përfaqësuesi i trashëgimtarëve të Q. K/shitësi dhe H.G/blerësi është një akt që provohet se blerësi ka paguar kaparin në shumën 500.000 lekë për shitjen e pasurisë në të ardhmen. Nuk është e qartë dhe nuk provohet shitja e pasurisë sipas kësaj kontrate në shumën 3.000.000 lekë. Subjekti nuk ka depozituar kontratën finale të shitblerjes së pasurisë, apo një akt që të provohej transferimi i pronësisë nga shitësit te blerësit. Ky është një akt që provon pagimin e kaparit, por jo shitjen e pasurisë në shumën totale prej 3.000.000 lekësh. Për këtë arsye, në analizën financiare do të reflektohet vetëm 1/7 e shumës së kaparit.
- Në dy aktet e tjera, sjellë nga subjekti kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 12.6.1998 dhe kontratë nr. \*\*\*, datë 26.6.1998, janë përfshirë në analizën financiare shumat e përfituara nga e ndjera F.K, sipas pjesëve të saj takuese 1/14.

Nga verifikimi i akteve të depozituara nga subjekti rezulton se znj. F.K ka përfitur disa pasuri nga trashëgimia ligjore, por nuk provohet se nga shitjet e pronave të jenë përfitur shumat e pretenduara.

## **B. Të ardhurat e znj. A.V(kunata) për ndërtimin e apartamentit shtesë**

Subjekti ka shpjeguar<sup>29</sup> se: “Kontribuuese për ndërtimin e shtëpisë ka qenë edhe motra e bashkëshortit A.V, por nga punësimi në shtetin italian nuk ka dokumentacion provues për vitet 2003 – 2006, pasi në Itali detyrimi për arkivim dokumentesh është pesë vjet”.

Nga hetimi ka rezultuar mungesë dokumentacioni ligjor për të ardhurat *neto* të personit të lidhur A.V për vitet kur është kryer ndërtimi i apartamentit + verandë.

**6.4 Lidhur me periudhën e ndërtimit dhe koston e investimit**, në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka shpjeguar<sup>30</sup> se: “Ndërtimi është realizuar në periudhën kohore 2003 – 2006 dhe deklaruar si i përfunduar me formularin e vetëdeklarimit të datës 24.11.2006, nënshkruar nga F. K, nëna e bashkëshortit, e cila ka ndërruar jetë më vonë (në vitin 2007). Ndërtimi i përket një periudhe kohore shumë më parë se njohja dhe martesë ime me shtetasin Q.V dhe banimit tim në këtë banesë”.

Sipas deklarimeve të shtetasit Q.V, ndërtimi ka një kosto totale ndërtimi dhe mobilimi rreth 2.500.000 lekë.

## **6.5 Ndërtimi i verandës me sipërfaqe 48.9 m<sup>2</sup>**

a. Komisioni kreu hetime lidhur me kohën e mbylljes së verandës. Sipas të dhënave nga ASIG<sup>31</sup>-u rezulton se në fotografimin e vitit 2007, pasuria nr. \*\*\* ka kuota lartësie maksimale 107.2, ndërkohë pasuria me nr. nr. \*\*\* (veranda) ka kuota lartësie 103.1 (veranda). Nga ortofotot e viteve 2015 dhe 2018, veranda ka rezultuar e mbuluar me çati dhe dritare me vetrata, pra, e kthyer në ambient banimi.

<sup>29</sup>Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022.

<sup>30</sup>Depozituar në përgjigje të pyetësorit të tretë, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022.

<sup>31</sup>Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 28.4.2022.

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar apartament *dublex* me sip. 103.4 m<sup>2</sup>, i cili ka edhe një sipërfaqe prej 48.9 m<sup>2</sup> verandë, e përfshirë në legalizim dhe e pasqyruar në lejen e legalizimit dhe në ZVRPP-në Tiranë. Referuar akteve nga ALUIZNI, rezulton se sipërfaqja e apartamentit është 103.4 m<sup>2</sup> dhe veranda 48.9 m<sup>2</sup>, aktualisht veranda paraqitet sipërfaqe e mbyllur, e shtuar ambienteve të banimit.

Nga sa më sipër, është konstatuar se bashkëshorti nuk ka deklaruar këto ndryshime, pra kthimin e verandës në sipërfaqe banimi dhe as shpenzimet për këtë investim.

Subjekti, e pyetur nga Komisioni në lidhje me periudhën e ndërtimit të shtesës dhe koston, ka shpjeguar<sup>32</sup> se: “... çatia me konstruksion druri dhe vetrata ka përfunduar në vitin 2007<sup>33</sup>. Që nga ky moment e në vijim ky ambient (shtesë kati 51 m<sup>2</sup> mbi pallatin ekzistues + verandë 48.9 m<sup>2</sup>) ka funksionuar si ambient banimi”.

Sipas të dhënave të marra nga aplikacioni *Google Earth Pro*, nga fotografimi në qershor të vitit 2007, veranda paraqitet sipërfaqe e hapur, e pambuluar. Nga pamje të ofruara nga ky aplikacion nga fotografim i vitit 2009, veranda paraqitet e mbuluar me çati.

Sa më sipër, duket qartë se ky investim është kryer nga bashkëshorti i subjektit përpara martesës, pra, sipas deklarimeve të subjektit në fund të vitit 2007.

b. Në lidhje me koston e ndërtimit të shtesës, subjekti është shprehur<sup>34</sup> se: “Në lidhje me vlerën e këtij investimi (verandë) theksojmë se kjo vlerë është përfshirë në vlerën e deklaruar më parë të Apartamentit në tërësi/citojmë sipas deklarimeve të bashkëshortit shtetasit Q.V ndërtimi ka një kosto total ndërtimi dhe mobilimi prej rreth 2.500.000 lekë ...

*Nisur nga sa më lart dhe bazuar në faktin që sipërfaqja ‘verandë’ është pothuajse 1/3 e gjithë ndërtimit/apartament. Duhet të theksojmë se, nisur nga koha shumë e gjatë e kaluar, nga natyra e ndërtimit dhe mënyra e realizimit të ndërtimit dhe mobilimit (shtrirë në kohë), si dhe nga fakti që bashkëshorti nuk ka qenë subjekt i ndonjë deklarimi, nuk kemi dokumentacion provues”.*

Nga hetimi i kryer u konstatua deklarim i pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi pasuria është deklaruar “apartament banimi me sip. 103.4 m<sup>2</sup> + 48.9 m<sup>2</sup> verandë”, ndërsa nga hetimi ka rezultuar apartament banimi *dublex* me sipërfaqe totale banimi rreth 152 m<sup>2</sup>.

## 6.6 Analiza financiare

Referuar dokumentacionit në dosjen e ALUIZNI-t, duket se në vitin 2011 janë paguar disa detyrime për taksa ndërtesë, si dhe për blerjen e parcelës ndërtimore. Nga përlllogaritja e shumës duket se bashkëshorti i subjektit ka paguar 2/5 e shumës totale prej 226.497 lekësh ose 90.599 lekësh. Kjo shumë është konsideruar si shpenzim i vitit 2011, pasqyruar në tabelën e analizës financiare.

Lidhur me koston e ndërtimit të shtesës dhe mobilimit është deklaruar shuma 2.500.000 lekë.

<sup>32</sup>Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2022.

<sup>33</sup>Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka depozituar foto nga aplikacioni *Google Earth*: viti 2009 - muaji qershor, ku del shumë qartë që objekti ka qenë i përfunduar/mbuluar me çati; dhe foto e prillit 2012, ku del qartë se kemi të bëjmë me të njëjtën pamje; aktekspertim nga eksperte e licencuar, i depozituar pranë ALUIZNI-t dhe në dosjen e praktikës së legalizimit, ku pasqyrohet shtesë anësore 5 kate dhe kati i pestë është realizuar me çati; akt i vitit 2009 mbi vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila është ndarë në pesë-pjesë dhe për shtetasen F.K jepen dy kate (sip. 49.18 m<sup>2</sup> kati i katërt dhe 92.3 m<sup>2</sup> - kati i pestë në total) (dy fletë).

<sup>34</sup>Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2022.



Kostoja e ndërtimit të shtesës me sip. 103.4 m<sup>2</sup> u llogarit duke marrë si referencë çmimet e EKB-së për vitin 2006, kur është deklaruar si ndërtim i përfunduar. Sipas udhëzimit të EKB-së, për vitin 2006, kostoja e ndërtimit ka rezultuar në shumën 2.612.091 lekë. Në analizë u përfshi:

- shuma 350.000 lekë e mobilimit për shtesën sipas deklarimit;
- për periudhën 1994 – 2006, të ardhurat e ligjshme nga pagat e bashkëshortit të subjektit, z. Q.V, janë në shumën 2.441.093 lekë, të cilat janë marrë në konsideratë në analizë;
- të ardhurat e ligjshme të nënës së bashkëshortit nga shitjet e pronave janë përfshirë në analizë si të ardhura të siguruara nga dy kontrata shitjeje të vitit 1998, në vlerën totale 23.714 lekë;
- të ardhurat nga punësimi i motrës nuk u dokumentuan për periudhën e pretenduar;
- shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave deri në vitin 1999 dhe sipas standardit të ILDKPKI-së, për periudhën 2000 – 2006, për bashkëshortin e subjektit, z. Q.V, dhe nënën e tij;
- shpenzim për blerje automjeti nga bashkëshorti i subjektit në shumën 250.000 lekë në vitin 2005.

#### **Analiza financiare për ndërtimin e apartamentit *dublex***

<b>Përshkrimi</b>	<b>1994 – 2006</b>
Të ardhurat nga paga e Q.V për periudhën 1994 – 1999	459 141
Të ardhurat nga paga e Q.V për periudhën 2000 – 2006	1 958 184
Të ardhura nga shitjet e pronave të F. K	23 714
<b>Të ardhura totale</b>	<b>2 441 039</b>
<b>Investimi në shtesë</b>	<b>2 612 091</b>
<b>Shpenzime mobilimi</b>	<b>350 000</b>
<b>Blerë automjeti tip “Mercedes-Benz” në vitin 2005</b>	<b>250 000</b>
<b>Likuiditete në bankë</b>	<b>1 000 164</b>
Shpenzime jetese 1994 – 1999	303 033
Shpenzime jetese 2000 – 2006	1 377 448
<b>Shpenzime jetese total</b>	<b>1 680 481</b>
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-3 451 697</b>

Nga analiza financiare e kryer ka rezultuar balancë negative në shumën **3.451.697 lekë**.

#### **6.7 Analiza financiare për kthimin e verandës në ambient banimi**

Vlera e investimit të sip. 48.9 m<sup>2</sup> të verandës, e përlllogaritur si e kryer në vitin 2007 dhe bazuar në çmimet e EKB-së, rezulton në shumën totale 1.222.158 lekë (çmimi për metër katror sipas EKB-së i publikuar 24.993 lekë).

Nga verifikimi i të dhënave bankare ka rezultuar se në emër të shtetasit Q.V është çelur një depozitë në shumën 1.001.000 lekë, e hapur në “Credins Bank” në datën 16.8.2006. Kjo depozitë është tërhequr *cash* pjesërisht në datën 12.3.2007 në shumën 500.000 lekë dhe në datën 16.8.2007 në shumën 350.000 lekë.

Komisioni analizoi mundësitë financiare për investimin e kryer për mbylljen e verandës, sipas tabelës vijuese.

Përshkrimi	2007
Të ardhurat nga paga Q.V, viti 2007	394 440
Investimi në verandë	1 222 158
Pakësim i depozitës bankare	-823 472
Shpenzime jetese	136 620
<b>Rezultati financiar</b>	<b>-140 866</b>

### 6.8 Konstatime të Komisionit për apartamentin *dublex*:

- Nuk provohen të ardhurat e ligjshme të familjes V, për investimin e kryer në ndërtimin e shtesës me sip. 102.4 m<sup>2</sup>, duke rezultuar me balancë negative në shumën **3.451.697 lekë**.
- Nuk provohen të ardhurat e ligjshme të familjes V, për investimin e kryer në ndërtimin/mbylljen e verandës me sip. 48.9 m<sup>2</sup>, duke rezultuar me balancë negative në shumën **140.866 lekë**.
- Ka deklarim të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi pasuria është deklaruar “*apartament banimi me sipërfaqe 103.4 m<sup>2</sup> + 48.9 m<sup>2</sup> verandë*”, ndërsa nga hetimi ka rezultuar apartament banimi *dublex* me sipërfaqe banimi rreth 152 m<sup>2</sup>.
- Ka mospërputhje deklarimesh lidhur me burimin e krijimit të shtesës, pasi në DPV-në e vitit 2010 janë deklaruar si burim të ardhurat e nënës nga shitjet e pronave, ndërsa në deklaratën *Vetting*, veç të ardhurave të nënës nga pronat është shtuar edhe kontributi i bashkëshortit të subjektit dhe motrës së tij.

Në lidhje me këto konstatime subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

### 6.9 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka pretenduar se:

i. Kjo pasuri është krijuar para martesë nga familja e bashkëshortit në vitet 2003 – 2007 me të ardhura të krijuara prej tyre dhe në një kohë që subjekti as nuk njihet me bashkëshortin. Bashkëshorti i subjektit ka fituar statusin e personit të lidhur pas martesës me subjektin në datën 13.7.2010.

ii. Subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit për deklarim të pasaktë të pasurisë, pasi ka deklaruar *dublex* dhe verandë, ndërkohë që apartamenti nuk dispononte më verandë, por ishte e gjitha sipërfaqe banimi, duke pretenduar se: “*Apartamenti nuk ka pësuar ndryshim/ka qenë gjithmonë që pas përfundimit të ndërtimit, tërësisht apartament banimi dhe jo sipërfaqe banimi dhe verande dhe, në këtë kontekst, nuk kishim pse deklaronim ndryshim në të*”.

Në deklaratën *Vetting* është referuar akti ligjor sipas dokumentit të ALUIZNI-t të kohës dhe ZVRPP-së, për të qenë plotësisht korrekt me aktet ligjore. Subjekti ka argumentuar se në DPV e parë, ka deklaruar apartament me sip 140 m<sup>2</sup>, duke mos cituar termin “verandë”.

iii. Në lidhje me mospërputhjen e burimit të krijimit, subjekti ka shpjeguar se burimi kryesor i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat e përfituara nga pronat e nënës. Duke qenë se kanë qenë të tre në një familje (z. Q.V banonte me nënën) dhe qëllimi ishte i përbashkët për zgjerimin

e hapësirës familjare dhe realizimin e ndërtimit, nuk mundet që kontributi i tyre të mbetet jashtë ndërtimit, i cili është shtrirë në kohë.

iv. Shtetasit Q.V dhe F.K e kanë ndërtuar apartamentin shtesë në periudhën 2003 – 2007 dhe të dy personat nuk kanë pasur statusin e “personave të lidhur” me subjektin e rivlerësimit në periudhën e ndërtimit, për pasojë nuk kanë pasur as detyrimin që të dokumentonin kostot e ndërtimit të shtesës e të ruanin dokumentacionin.

v. Subjekti ka kundërshtuar koston e ndërtimit të llogaritur nga Komisioni, sipas EKB-së, duke pretenduar se ndërtimi nuk është bërë me firmë ndërtimi, si dhe ndërtimi ka karakteristikat e veta, në pikëpamje të strukturës, materialeve të lehta të përdorura në ndërtim, mungesës së themeleve, etj. Subjekti pretendon se çmimet e EKB-së për shtesën “verandë” nuk përjashtojnë shpenzimet për themelet.

Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar një raport vlerësimi nga një ekspert ku ka përcaktuar se vlera e investimit është më e ulët se ajo e gjeneruar nga Komisioni, bazuar në EKB dhe argumenton se kjo vlerë është e përafërt me atë që bashkëshorti ka deklaruar.

vi. Subjekti ka pretenduar që Komisioni të rikryejë analizën financiare, pasi periudha për ndërtimin e shtesës me sip. 104 m<sup>2</sup>, shtrihet në vitet 2003 – 2006. Përlllogaritja e Komisionit, bazuar në çmimet e EKB-së vetëm për vitin 2006, nuk është e saktë nga ana e Komisionit dhe ky fakt e ka rënduar situatën financiare të subjektit.

vii. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka depozituar dokumentacion provues shtesë në lidhje me të ardhurat e ligjshme të vjehrrës, përfituar nga pensioni për periudhën 1990 – 2006, në vlerën 1.358.845 lekë, të cilën ka kërkuar që t'i përfshihet në analizën financiare të investimit deri në vitin 2006.

viii. Gjithashtu, subjekti, për të ardhurat e ligjshme të nënës së bashkëshortit ka depozituar kontratën e sipërmarrjes të datës 4.12.2001, me vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\*, datë 4.12.2001, të noteres I.B, lidhur mes pronarëve të truallit (ku bën pjesë edhe F.K) dhe shoqërisë “A” sh.p.k. ndërtuese/investitore, përfaqësuar nga shtetasi K.Z.

Subjekti ka pretenduar se në këtë kontratë gjendeshin edhe përqindjet përfituese të pronarëve të truallit në masën 19% të ndërtimit. Në vijim dhe zbatim të kontratës gjendej edhe deklarata për heqje të barrës hipotekore, që përbën provë të plotë të kalimit të shumës 26.700.000 lekë te pronarët e truallit. Subjekti ka pretenduar se nëna e bashkëshortit, në këmbim të pjesës takuese të truallit në pronësi të saj, ka përfituar 14% të shumës së mësipërme, e barabartë me 1.907.142 lekë. Nga kontrata e sipërmarrjes referohet se pronarët e truallit do të përfitonin 19% të ndërtimit dhe nuk referohet se këtë pjesë të ndërtimit do ta përfitonin të konvertuar në lekë.

## **6.10 Vlerësimi i Komisionit**

Në lidhje me pasurinë *dublex* me sip. 150 m<sup>2</sup>, Komisioni konstaton se:

i. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të pasurisë në deklaratën *Vetting*, duke pasqyruar 104 m<sup>2</sup> + 48.9 m<sup>2</sup> verandë, pasi kjo nuk pasqyron gjendjen faktike të pasurisë. Subjekti, në deklaratën *Vetting* kishte detyrimin të deklaronte pasurinë, jo vetëm referuar aktit të regjistrimit të pasurisë, por edhe situatën faktike të kësaj pasurie në momentin e deklaramit. Trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi duhet vlerësuar në raport me pozitën e subjektit me këtë pasuri,

verifikimin e burimeve të krijimit, për sa ato lidhen me subjektin, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave të dala nga hetimi.

ii. Mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, analiza financiare pas prapësimeve pësoi ndryshime, pasi në të janë reflektuar të ardhurat e ligjshme të vjehrrës, përfituar nga pensioni për periudhën 1990 – 2006, në vlerën 1.358.845 lekë. Këto shuma janë përfshirë në analizën financiare të investimit të kryer për periudhën deri në vitin 2006.

iii. Mbështetur në pretendimet e subjektit u rikrye analiza financiare për ndërtimin e shtesës duke u përlllogaritur vlera e investimit e shpërndarë në 4 vjet, sipas çmimeve të EKB-së për vitet 2003 – 2006.

iv. Për të provuar burimet e ligjshme të vjehrrës për investimin e kryer, subjekti në prapësime, ka depozituar kontratën e sipërmarrjes, nr. \*\*\*, datë 4.12.2001, me vërtetim nënshkrimi të noteres I. B., lidhur mes pronarëve të truallit (ku bën pjesë dhe F.K) dhe shoqërisë ndërtuese/investitore “A” sh.p.k., përfaqësuar nga z. K.Z.

Në këtë kontratë gjejmë edhe përqindjet përfituese të pronarëve të truallit në masën 19% të ndërtimit. Kjo shumë është e njëjtë me sa përmban edhe deklarata për heqje barre hipotekore. Në vijim dhe zbatim të kontratës gjendet edhe deklarata për heqje të barrës hipotekore, ku deklarohet se bashkëpronarët e truallit, në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, datë 4.12.2001, kanë marrë shumën 26.700.000 lekë, në shkëmbim të truallit. Subjekti ka pretenduar se nëna e bashkëshortit në këmbim të pjesës takuese të truallit në pronësi të saj ka përfituar 14% të shumës së mësipërme të barabartë me vlerën 1.907.142 lekë. Nga kontrata e sipërmarrjes referohet se pronarët e truallit do të përfitonin 19% të ndërtimit dhe nuk referohet se këtë pjesë të ndërtimit do ta përfitonin në lekë.

v. Në analizim të konstatimeve të Komisionit, në lidhje me mungesën e dokumentacionit për të provuar burimet e ligjshme të vjehrrës së subjektit, por dhe të mungesës së burimeve të ligjshme, që rezultuan gjatë hetimit për apartamentin e bashkëshortit të krijuar para martesë, marrin rëndësi faktet objektive dhe ligjore që janë të lidhura me:

a) Faktin se nga hetimi i kryer nuk rezultuan të dhëna që subjekti dhe bashkëshorti të kishin bashkëjetuar para lidhjes së martesës ligjore në datën 12.7.2010.

b) Faktin se ky ndërtim, sipas formularit për legalizim të ndërtimit informal, është bërë nga e ndjera F.K, nëna e bashkëshortit të subjektit, në vitin 2006, para martesës së subjektit me bashkëshortin.

c) Faktin se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat e nënës së bashkëshortit nga shitja e pasurive të fituara me trashëgimi përpara<sup>35</sup> se të fillonte ndërtimi i apartamentit.

Në lidhje me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 28.1.2004, të administruar nga ILDKPKI-ja, sipas së cilës shoqëria “A” sh.p.k. ka paguar shumën 26.700.000 lekë, për 14 bashkëpronarët e tokës, në shkëmbim të truallit të dhënë për ndërtim, duke qenë se këto të ardhura dhe vetë akti noterial i përkasin periudhës përpara se subjekti të martohej me bashkëshortin, Komisioni vlerësoi të mos kryejë hetime të mëtejshme lidhur me legjitimitetin e të ardhurave të konfirmuara nga përmbajtja e këtij akti.

---

<sup>35</sup>Aktet ligjore të pronave të të ndjerës F.K datojnë që pas vitit 1993 vendimet e KKKP dhe në vijim nga viti 2001 kontratën e sipërmarrjes të datës 4.12.2001.

ç) Në kohën kur janë përfituar këto të ardhura nga vjehrra e subjektit, por edhe kur është investuar në ndërtimin e shtëpisë, për periudhën 2003 – 2006, z. Q.V dhe nëna e tij nuk e gëzonin statusin e personave të lidhur të një subjekti rivlerësimi. Në këtë periudhë z. Q.V nuk gëzonte as statusin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, këta persona nuk kanë pasur asnjë detyrim për të mbajtur dhe ruajtur provat në lidhje me pasuritë e tyre dhe aq më pak për dokumentimin e të ardhurave që do të përdreshin për investim në të ardhmen.

d) Koha e gjatë që ka kaluar që nga përfitimi me trashëgimi i pronave nga vjehrra e subjektit dhe të ardhurave e krijuara nga shitjet e tyre<sup>36</sup>, si dhe fakti që këto të ardhura janë disponuar nga vjehrra, e cila ka ndërruar jetë në vitin 2007, e vënë subjektin në kushtet e pamundësisë për të justifikuar plotësisht burimet e ligjshme në përputhje me nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

Në vlerësim tërësor të të gjitha fakteve dhe rrethanave të përmendura sa më sipër, marrin rëndësi faktet se krijimi i të ardhurave dhe investimi në ndërtimin e shtesës apartament *dublex* i takojnë një periudhe përpara se subjekti të ishte pjesë e familjes V.

Pavarësisht ekzistencës së rrethanave të mësipërme, trupi gjykues evidenton faktin se hetimi i kësaj pasurie ka qenë detyrim ligjor, për sa kohë është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, pasi kjo pasuri që nga viti 2010 e në vijim është zotëruar nga subjekti. Megjithatë, vlerësimi i kësaj pasurie nuk duhet të shihet i shkëputur nga analizimi i gjendjes faktike e juridike të saj. Për këtë shkak, Komisioni verifikoi origjinën e kësaj prone, mënyrën e përfitimit të saj nga pronarët, kohën e krijimit të saj, si dhe burimin e krijimit.

Në përfundim të hetimit trupi gjykues çmon se në këtë çështje merr vlerë të veçantë fakti se nga hetimi u provua se për krijimin e kësaj pasurie, si dhe të shtesës së saj, subjekti i rivlerësimit nuk kishte kontribuar financiarisht me të ardhurat e saj.

Balanca negative dhe pse e konsiderueshme e rezultuar nga analiza e kryer për vitet 2003 – 2006, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin me pasojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për të njëjtën arsye, edhe pasaktësitë në deklarime, nuk vlerësohen si shkak për penalizim të subjektit. Në këtë vlerësim, Komisioni i është referuar edhe standardit të mbajtur nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>37</sup> për raste të ngjashme lidhur me pasuri të krijuara nga personat e lidhur/bashkëshortit përpara martesës.

## **7. Pasuri e paluajtshme<sup>38</sup> me sip. 1179 m<sup>2</sup>, në Vlorë**

Kjo pasuri është në bashkëpronësi, me pjesë takuese 1/28 dhe është deklaruar në deklaratën *Vetting* si pasuri e përfituar para martesë. E fituar me trashëgimi ligjore. Në DPV-në e vitit 2010 është deklaruar, njohur me vendim të KKKP-së dhe kthyer sipas ligjit. Në bashkëpronësi me shumë pjesëtarë të tjerë trashëgimtarë.

<sup>36</sup>Aktet e depozituar nga subjekti për pronat e vjehrrës i takojnë periudhës 1993 e në vijim.

<sup>37</sup>Shihni vendimin nr. 6/2019 (JR), datë 28.2.2019, të subjektit të rivlerësimit A.S.

<sup>38</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë nr. \*\*\*, datë 11.8.2009, në ZVRPP-në Vlorë, të pasurisë truell me sip. 1179 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, me ndërtim \*\*\*, në Lagjen “\*\*\* Nëntori”, z. k. \*\*\*, vol. \*\*, f.\*\*, të 19 bashkëpronarëve; kartë e pasurisë së paluajtshme, të pasurisë truell me sip. 1179, nr. pasurie \*\*\*, me ndërtim \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*\* dhe vijon vol. \*\*, f.\*\*\*, në emër të shtetasit Q.V, me 1/28 pjesë dhe shtetasja A.V me 1/28 pjesë; lista e bashkëpronarëve; vërtetim pronësie nga Ministria e Drejtësisë, vërtetohet se në emër të shtetasve L.T, Q.C. D.P, F.K, A.K, B.K dhe R.K janë të regjistruara pasuritë si më poshtë. Në lagjen “\*\*\* Tetori” një fabrikë vaji me sip. 596.6 m<sup>2</sup>, një magazinë me sip.155 m<sup>2</sup> në lagjen “O.H” një godinë me destinacion fabrikë vaji me sip.139.9 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri është e regjistruar në regjistrin e hipotekës nr. \*\*\*, datë 10.8.1994.

## 7.1 Hetimi i Komisionit

**ZQRPP-ja**<sup>39</sup> ka konfirmuar se në emër të shtetasve A dhe Q.V(Q.K) dhe bashkëpronarëve të tjerë është regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*, z. k. \*\*, pasuri e llojit “truall”, me sip. truall 1179 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtese 1025m<sup>2</sup>, pasuri e cila vijon nga vol. \*\*, f. \*\*, e cila gjithashtu vijon nga vol. \*\*, f. \*\*, e regjistruar më 9. 7.2009.

**ASIG**<sup>40</sup> ka depozituar *ortofoto*, përkatësit të viteve 1994, 2001, 2007 dhe 2015. Fotografimet ajrore të viteve 2007 dhe 2015 janë në efekt 3D, ku mund të përcaktohen kuotat e lartësisë së ndërtesave, të cilat janë thujse të barabarta.

Në fotot e nxjerra në vitet 1994 dhe 2001, duket se në pasurinë me nr. \*\*\* ka ndërtime, por duke qenë se janë në format 2D, pra mungon lartësia, nuk identifikohet nëse ka pasur ndryshime në ndërtime nga viti 2009 e në vijim.

## 7.2 Analiza e fakteve

**ASHK-ja Vlorë**<sup>41</sup> ka informuar se nga verifikimet e kryera rezulton se në z. k. \*\*\* është regjistruar pasuria me sipërfaqe truall 1179 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtese 1025 m<sup>2</sup>. Origjina e pasurisë së mësipërme është vendimi nr. \*\*, datë 3.12.1993, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vendim i cili është ndryshuar/saktësuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.6.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Referuar certifikatës me nr. \*\*\*, datë 11.8.2009, të ZVRPP-së Vlorë, rezulton se bashkëshorti i subjektit është bashkëpronar me 1/28 pjesë të pasurisë truall me sip. 1179 m<sup>2</sup> dhe ndërtim me sip. 1025 m<sup>2</sup>. Subjekti ka depozituar aktin<sup>42</sup> e trashëgimisë së shtetasit Q.K, nga ku rezulton se shtetasja F. K është një nga 7 trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Q.K.

**ASHK-ja Vlorë** nuk ka dhënë informacion për pasuritë në pronësi të bashkëshortit të subjektit, pasi nga sistemi dixhital nuk rezultojnë të dhëna për këtë pasuri, ku shtetasi Q.V rezulton bashkëpronar.

Subjekti, e pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar<sup>43</sup> se: *“Kjo pronë është fituar nga ish-pronari Q. K dhe bashkëshortit i vjen nga nëna e tij F.K.*

*Lidhur me ndërtesën që figuron në certifikatë, sipas informacionit të dhëne nga bashkëshorti Q. V, ndërtesa përbehej nga një mur rrethues që do të shërbente për të ngritur Q.K fabrikë vaji, por që nuk u realizua për shkak se pronat u morën nga shteti i asaj kohe.*

*Sot, nga informacioni i marrë, brenda konturit të këtij rrethimi ndodhen ndërtime informale nga të tretët, me të cilët nuk kemi asnjë marrëdhënie personale dhe juridike. Në lidhje me tërësinë e pronës, truall dhe ndërtim, nuk kemi pasur ndonjëherë deri më sot asnjë lloj marrëdhënieje konkrete dhe asnjë lloj përfitimi/asnjë të ardhur.*

<sup>39</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2017 ka bashkëlidhur përgjigjen negative të ZVRPP-së Vlorë. ZVRPP-ja Vlorë, me e-mail datë 6.11.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>40</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2022.

<sup>41</sup>E-mail i ZVRPP-së Vlorë, i datës 6.11.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>42</sup>Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022.

<sup>43</sup>Të tretët ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2022.

*Këto pasuri janë vetëm në dokumente, ndërkohë që duhet të theksojmë se dhe informacionin e mësipërm bashkëshorti im e ka marrë nga familjarët, pasi ai vetë nuk ka dijeni mbi vendndodhjen konkrete fizike të pronës së mësipërme”.*

### **7.3 Konstatime të Komisionit**

Rezultoi i paqartë statusi i ndërtesës me sip. 1.025 m<sup>2</sup> dhe disponimi i saj nga bashkëpronarët, sipas shpjegimeve të subjektit.

Nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklarinimin e parë të bashkëshortit në vitin 2010, ndërtesa me sip. 1025 m<sup>2</sup>, e ndodhur brenda këtij trualli.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

### **7.4. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

i. Në lidhje me konstatimet e Komisionit për mosdeklarim nga subjekti të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë truall, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mund të ketë një konceptim të gabuar në pikëpamje të detyrimit për deklarim në sensin që kanë deklaruar “truall” me sip. 1179 m<sup>2</sup> dhe jo “ndërtesën” mbi të, por ky detyrim është ezauruar plotësisht për sa kohë që:

- kanë bërë një evidentim të qartë të pasurisë duke përcaktuar numrin e saj \*\*\*, në të cilën përfshihet trualli dhe ndërtimi; dhe
- faktin që kjo pasuri ndodhet e regjistruar në regjistrat publikë.

ii. Siç edhe del nga certifikata e vitit 2009, është pasuri e bashkëshortit, e ardhur me trashëgimi nga nëna dhe, si e tillë, nuk ka asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit.

iii. Lidhur me statusin e ndërtesës me sip. 1.025 m<sup>2</sup> theksohet se edhe për ta (subjektin dhe bashkëshortin) nuk është shumë e qartë situata e saj. Situata është e paqartë, pasi në gjendje fakti kjo fabrikë/muri rrethues i saj është mbushur me ndërtime, të cilat të tilla duhet të jenë/të kenë qenë të paligjshme për sa kohë kemi kthim të truallit.

Nisur nga gjendja në të cilën paraqiten këto ndërtime, të cilat janë të rrënuara, nuk kanë asnjë lidhje dhe asnjë lloj përfitimi, asnjëherë.

Sa më lart, mbetet i paqartë ndërtimi, fabrika, nga vendimet e kohës, por theksojnë edhe një herë që kjo pronë për ata (duke qenë se Q. V është bashkëpronar në një pjesë të vogël 1/28) nuk ka paraqitur asnjë interes.

Aq më tepër që subjekti i rivlerësimit nuk ka/nuk ka pasur asnjë të drejtë dhe në mënyrë më absolute asnjëherë asnjë lloj akses mbi këtë pronë.

E tillë për ata si familje deri në këtë moment është vetëm me letra dhe deklaruar si e tillë: pasuria nr. \*\*\*.

Subjekti ka depozituar kartelë të rifreskuar të pasurisë dhe fragment të hartës kadastrale të datës 2.6.2022, ku pasqyrohet pasuria me sip. 1179 m<sup>2</sup> truall dhe sip. 1025 m<sup>2</sup> ndërtim, pa asnjë ndryshim. Gjithashtu, subjekti, në prapësime, ka depozituar fotografime të pasurisë, nga ku ka rezultuar se ka ndërtime shumë të vjetra, të rrënuara.

### **7.5 Vlerësimi i Komisionit**

Subjekti, në prapësime, ka depozituar kartelë të rifreskuar të pasurisë dhe fragment të hartës kadastrale të datës 2.6.2022, ku pasqyrohet pasuria me sip. 1179 m<sup>2</sup> truall dhe 1025 m<sup>2</sup> ndërtim. Në këtë pasuri nuk rezulton që të ketë ndryshime apo investime në vite, ndërkohë që nga fotot e sjella nga subjekti dhe nga *ortofotot* e ASIG-ut, rezulton se brenda kësaj pasurie ka ndërtime informale, të cilat nuk janë pasqyruar në këtë kartelë.

Subjekti, në prapësime, por edhe në seancë ka pranuar statusin e paqartë të pronës, duke argumentuar se janë thjesht titullarë të saj, me 1/28 pjesë takuese dhe ndërkohë nuk kanë ndonjë zotërim efektiv apo përfitim prej kësaj pasurie, e përfituar me trashëgimi para martesës.

Gjatë hetimit nuk rezultuan të dhëna mbi veprime të kryera për zhvillimin e pronës/apo ndonjë përfitim financiar nga bashkëshorti i subjektit, në lidhje me këtë pronë.

Përfundimisht, u konkludua se subjekti ka shpjeguar bindshëm dhe dokumentuar se mbi këtë pasuri nuk janë kryer investime nga bashkëpronarët dhe se nuk ka zotërim faktik apo përfitim prej kësaj pasurie.

## **8. Truall<sup>44</sup> me sipërfaqe 744 m<sup>2</sup>, në Tiranë**

Kjo pasuri ndodhet në lagjen “Tirana e Re”, njohur për efekte kompensimi trashëgimtarëve të z. Q.V. Pasuri e krijuar para martesë. Pjesa takuese: zotëruar me ¼ pjesë në bashkëpronësi me motrën. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti e ka deklaruar të përfituar me trashëgimi me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2007, të AKK Pronave, i cili ka ndryshuar vendimin nr. \*\*\*, datë 29.2.1996, të KKKP-së Tiranë. Çmimi aktual paraqitet në vartësi të tregut të lirë për këto lloj pasurish. Pjesa takuese: zotëron 1/4.

### **8.1 Hetimi i Komisionit**

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2007, ka vendosur:

- Të njohë z. Q.V (trashëgimtarët e tij), ish pronar të një prone të përbërë nga një truall me sip. 744 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “Tirana e Re”, Tiranë, me nr. \*\*\* të parcelës që kufizohet: lindje me parcelën nr. \*\*\*, perëndim me rrugë, veriu me shëtitore dhe jugu, ish-parcelë \*\*\*.
- Trualli i zënë me ndërtime të përhershme me sip. 744 m<sup>2</sup> (pallat 5-katësh, trotuar, rrugicë dhe shesh midis pallatit) dhe në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, të kompensohet pronari Q.V (trashëgimtarët e tij) për sipërfaqen e truallit të mësipërm me një nga format e parashikuar nga ligji.

**Agjencia e Trajtimit të Pronave – Drejtoria e Kompensimit<sup>45</sup>** informon se nuk rezulton që shtetasi Q.V të ketë përfituar kompensim financiar për vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2007, të ish AKKP-së.

---

<sup>44</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/9) vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2007, të AKK Pronave, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 29.2.1996, të KKKP-së Tiranë. Ky vendim i njohu z. Q.V (trashëgimtarët e tjerë) një truall me sip. 774 m<sup>2</sup>, që ndodhet në lagjen “Tirana e Re”, Tiranë. Trualli i zënë me ndërtime të përhershme pallat 5 kat, me sip. 744 m<sup>2</sup> do të kompensohet me sip. e truallit të mësipërm; vendimin nr. \*\*\*, datë 29.2.1996, nga KKKP-ja, njësi si pronar Q. V dhe trashëgimtarët e tij për truallin me sip. 744 m<sup>2</sup>, i zënë me ndërtime të përhershme pallat 5 kat me sip. 744 m<sup>2</sup>, do të kompensohet pas 99 vjetësh, sipas kontratës së qirasë së sipërfaqes së truallit të mësipërm.

<sup>45</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2022.



Në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar<sup>46</sup> se: “Që nga momenti i marrjes së vendimit nga KKKP-ja dhe njohjes së kësaj pasurie për efekt kompensimi, familja e bashkëshortit deri më sot nuk ka përfituar asnjë lloj kompensimi real”.

Nga hetimi i kryer, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

### **9. Ullishte<sup>47</sup>, me sipërfaqe 20.000 m<sup>2</sup>, në Vlorë**

Kjo pasuri është në bashkëpronësi, me pjesë takuese 1/28 pjesë, te zona G e Sh. Pasuria është përfituar nga bashkëshorti i subjektit para martesë, me trashëgimi ligjore nga gjyshi Q.K, si e përfituar me ligjin nr. 7501/1991, datë 23.12.1992, me AMTP-në nr. \*\*\*, datë 15.10.1996.

- Nga hetimi i kryer nuk rezultuan problematika.

### **10. Automjet tip “PEUGEOT”<sup>48</sup>, dhuruar bashkëshortit në vitin 2012**

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si dhe në DPV-në e vitit 2012 automjetin e dhuruar nga vjehri i motrës. Pasuri e përfituar me kontratë dhurimi me datë 14.12.2012.

#### **10.1 Hetimi i kryer nga Komisioni**

**DPSHTRR-ja**<sup>49</sup> konfirmon se shtetasi Q. V ka në pronësi automjetin tip “PEUGEOT” me targa AA \*\*\* AX. Bashkëlidhur dosjes rezulton kontrata e dhurimit të automjetit me nr. \*\*\*, datë 14.12.2012, me palë dhuruese I.L dhe palë përfituese Q.V, të automjetit tip “PEUGOT”, vit prodhimi 2001, me targa AA \*\*\* AX.

Nga aktet e sjella nga DPSHTRR-ja ka rezultuar se dhuruesi I.L e ka blerë këtë automjet me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.1.2012, nga shtetasi S.S, në çmimin 100.000 lekë. Blerësi i parë që e ka futur në Shqipëri këtë automjet është shtetasi S.S, i cili e ka blerë automjetin në Gjermani, në shumën 600 euro në datën 8.7.2011. Automjeti është zhdoganuar në datën 26.7.2011, në shumën 110.000 lekë.

Në sistemin e AMF-së verifikohet se bashkëshorti i subjektit e ka ende këtë automjet dhe figuron si pronar e përdorues i saj. Bashkëshorti i subjektit ka blerë në mënyrë të rregullt policat e sigurimit të detyrueshëm për këtë automjet. Referuar dokumentacionit të depozituar<sup>50</sup> provohet se shtetasi I. L është vjehri i motrës, sikurse ka deklaruar subjekti.

Komisioni hetoi për ndonjë rast të mundshëm konflikti interesi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>51</sup> ka informuar se shtetasit I.H.L dhe S.I.L nuk kanë pasur ndonjë proces gjyqësor, ku gjyqtar të ishte subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora.

Automjeti tip “PEUGEOT \*\*\*” i është dhuruar bashkëshortit të subjektit me kontratën e datës 14.12.2012, nga z. I.L, i cili e ka blerë këtë automjet në shumën 100.000 lekë.

<sup>46</sup>Të tretë ardhur me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 9.3.2022.

<sup>47</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: AMTP-në nr. \*\*\* akti, në Vlorë, vendi i quajtur “G e Sh”, në emër të shtetasit Q.K, ullishte me sip. 20.000 m<sup>2</sup>.

<sup>48</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë dhurimi automjeti nr. \*\*\*, datë 14.12.2012, me palë dhuruese I.L dhe palë pranuese dhuratë Q.V, të automjetit tip “PEUGOT”, vit prodhimi 2001, me targa AA \*\*\* AX; kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 6.1.2012, me palë shitëse S.S dhe palë blerëse I.L, të automjetit tip “PEUGOT”, vit prodhimi 2001, me targa AA \*\*\* AX, në vlerën 100.000 lekë; certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targa AA \*\*\* AX në emër të Q.V.

<sup>49</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 15.7.2020.

<sup>50</sup>Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 20.4.2022.

<sup>51</sup>Shkresat: nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2022; dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2022.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë burimet e ligjshme të dhuruesit, në përputhje me sa parashikon neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016.

## **10.2 Analiza financiare**

Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues për të ardhurat e tij të ligjshme të dhuruesit dhe, si pasojë, ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit në shumën 100.000 lekë. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

## **10.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Për mungesën e burimeve të ligjshme që ka rezultuar për dhuruesin e automjetit, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të marrë në konsideratë rrethanat faktike si vijon:

- në momentin e dhurimit të këtij automjeti subjekti i rivlerësimet dhe bashkëshorti i saj kanë pasur në pronësi dy automjete: një “AUDI” dhe një “Mercedes-Benz”. Ky fakt tregon se nuk kanë pasur nevojë për automjet tjetër dhe në këtë kontekst, kanë dhurim të pranuar për sa kanë të bëjnë me një send me vlerë të tillë (me vit prodhimi 2001);
- vlera e sendit është në vlerë të vogël dhe mundësisht të realizueshme si nga dhuruesi ashtu edhe nga subjekti me çmim blerjeje 100.000 lekë;
- automjeti vjen që në origjinë të tij me një vlerë prej 600 euro;
- shtetasi I. L në vitet 2010 - 2012, paraqitet të ketë zotëruar në vijimësi të ardhura dhe të tilla i ka disponuar edhe në bankë/llogari apo në bono thesari, gjë që do të thotë se kishte mundësi objektive të mjaftueshme për një jetese të mirë/përveç faktit që trajtohej me pension /edhe për blerje të një automjeti me këtë vlerë. Aktet e depozituara gjatë hetimit provojnë tërësisht mundësinë objektive të dhuruesit z. I.L, të ardhura të mjaftueshme që në datën 16.1.2012 të ketë zotëruar një kapital prej 100.000 lekësh.

## **10.4 Vlerësimi i Komisionit**

Subjekti, në prapësime, argumentoi mbi disa rrethana faktike, por nuk depozitoi dokumentacion provues në përputhje me parashikimin ligjor të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni duke marrë në konsideratë faktet: (i) vlerën e vogël të automjetit prej 100.000 lekësh; (ii) mundësinë potenciale që kishte subjekti dhe bashkëshorti në atë periudhë për të bërë një blerje të tillë; (iii) posedimi nga familja e subjektit e dy automjeteve të tjera dhe faktin që nuk u nevojitej një automjet i tretë. Gjendja negative e rezultuar për këtë automjet u konkludua si jo me peshë dhe që të mund të penalizonte subjektin në vlerësimin tërësor të saj.

## **11. Depozita<sup>52</sup> në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortit, me gjendje në datën 5.1.2017 në shumat 721.582 lekë dhe 753.398 lekë**

Burim krijimi për të dyja depozitat janë të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit.

---

<sup>52</sup>Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/5) nxjerrje llogari bankare datë 24.10.2016, nga “Credins Bank”, në emër të shtetasit Q.V; nxjerrje llogari bankare datë 5.1.2017, nga “Credins Bank”, në emër të shtetasit Q.V, me gjendje në llogari në shumën 721.582 lekë; llogari bankare datë 12.10.2016, nga “Credins Bank”, në emër të shtetasit Q.V; nxjerrje llogari bankare datë 5.1.2017, nga “Credins Bank”, në emër të shtetasit Q.V, me gjendje në llogari në shumën 753.398 lekë; mini statamente datë 20.1.2017, në “Credins Bank” në emër të shtetasit Q.V, me gjendje në llogarinë e pagës 71.589 lekë; mini statamente datë 20.1.2017, në “Credins Bank”, në emër të shtetasit Enkela Vlora, me gjendje në llogarinë e pagës 16.891 lekë.

Sipas të dhënave të dokumentuara, këto depozita kanë si burim të ardhurat nga pagat e bashkëshortit dhe janë kredituar në mënyrë periodike me të ardhurat e pagës.

- Nga verifikimi nuk u konstatuan problematika.

### **DEKLARIMI I MOTRËS SË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT/A.V**

Motra e bashkëshortit të subjektit rezulton në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se shtetasja A.V ka përfituar apartamentin e privatizuar me sip. 53 m<sup>2</sup>, pas shkëmbimit, të trajtuar sa më sipër.

**ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Jug**<sup>53</sup> ka konfirmuar se shtetasja A.V ka të regjistruar pasurinë e llojit “apartament” me sip. 53 m<sup>2</sup>.

- Nga hetimi i Komisionit nuk u konstatuan problematika.

### **Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë**

Nga vlerësimi në tërësi i pasurive të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasuritë në deklaratën *Vetting* dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklarim të rremë. Ndërkohë, subjekti ka justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit.

Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen, për një vlerësim sa më objektiv, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, të cilat passjellin pasaktësi në deklarin e subjektit lidhur me burimet e ligjshme që kanë shërbyer për investimet në pasurinë e saj dhe të bashkëshortit në raport edhe me deklarin e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësim të përgjithshëm të dy kriterëve të tjera të rivlerësimit, çmon se proporcionalisht këto konstatime, si një shkak i vetëm dhe i veçuar, nuk janë të mjaftueshme për t’u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm dhe që mund të çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport<sup>54</sup> në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Enkela F. Vlora.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Nga hetimi administrativ, edhe pas përditësimit të të dhënave të ardhura nga autoritetet verifikuese, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

<sup>53</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2020.

<sup>54</sup>Në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, është dërguar raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin, me nr. \*\*\*, datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2021, të KDZH-së.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkela Vlora, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, në përputhje me germën “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshillit i Lartë Gjyqësor<sup>55</sup> (KLGJ) për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij); dhe
- denoncimeve të paraqitura nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit;
- tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të dhënat nga burimet arkivore; dhe
- pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË**

Në bazë të të dhënave që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, referuar edhe dosjes personale të subjektit të rivlerësimit, rezulton se znj. Enkela Vlora ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.1994. Fillimin në detyrë e ka sipas vendimit nr. 1, datë 30.3.1995, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku është emëruar ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas znj. Enkela Vlora, me vendimin nr. 83 datë 13.5.2000, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht.

KLGJ-ja<sup>56</sup> ka informuar se nuk rezultojnë të dhëna për procedime disiplinore apo propozim për ndonjë kërkesë për procedim disiplinor për këtë subjekt. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna për ndonjë masë të dhënë ndaj subjektit nga ish-KLD-ja.

### **ANALIZA E GJETJEVE**

#### **1. Aftësitë profesionale**

##### *a) Njohuritë ligjore*

Referuar raportit të hartuar nga KLGJ-ja, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora ka shfaqur aftësitë e duhura në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për zbatimin e saj në rastin konkret.

Ndër tri dokumentet e prezantuara nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 vendimet që u përkasin 5 dosjeve të përzgjedhura me short, janë ankimuar 6 prej tyre dhe në 5 raste vendimi i dhënë nga

<sup>55</sup>Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021.

<sup>56</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2021.

gjqtarja Enkela Vlora është lënë plotësisht në fuqi nga gjykata e apelit. Vetëm një vendim është cenuar pjesërisht. Dy vendime që u përkasin dosjeve të përzgjedhura me short kanë marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora ka shfaqur aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirës, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre.

## **2. Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti rivlerësimit Enkela Vlora, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se gjatë kësaj periudhe i janë caktuar për gjykim gjithsej 2520 çështje, ku ka përfunduar 1972 çështje, duke mbartur vitin e fundit 157 prej tyre. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 78.2%.

Rezulton se gjyqtarja Enkela Vlora për 3 vjet ka përfunduar së gjykuari 600 çështje civile dhe tregtare me palë kundërshtare. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka respektuar dhe tejkaluar standardin sasior sa i takon çështjeve civile të gjykuara, pa llogaritur çështjet e tjera civile (kërkesat civile) apo çështjet penale si kërkesa dhe masat e sigurimit.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora ka shfaqur aftësi mesatare për të kryer procedurat gjyqësore në 4 dosjet e vëzhguara. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, por janë evidentuar probleme në organizimin dhe planifikimin e punës, fakt që ka sjellë në tri raste zvarritje të gjykimit.

Në katër çështje civile themeli të vëzhguara, gjyqtarja ka kryer rregullisht veprimet përgatitore. Veprimet përgatitore janë dokumentuar rregullisht me procesverbal të mbajtur nga vetë gjyqtarja, por është mbajtur me një shkrim dore i cili rezultoi i palexueshëm.

Në analizë të dosjeve të vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora është pjesërisht efiçente në çështjet që ka shqyrtuar. Në shumicën e rasteve, gjykimet kanë përfunduar tej afateve ligjore apo standarde. Respektimi i kohës në gjykim përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor.

Në lidhje me procedurat gjyqësore të kryera nga subjekti, është konstatuar se:

- Procesverbalet e veprimeve përgatitore nuk janë mbajtur nga sekretarja me kompjuter, me qëllim që të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga cilido subjekt i interesuar. Konstatohet se gjyqtarja zhvillon shumë seanca përgatitore e, megjithatë, shtyn shumë seanca gjyqësore për të marrë prova, për t'u njohur palët me provat e njëra-tjetrës, për t'u dhënë kohë palëve për t'i sjellë provat në formën e kërkuar nga ligji, etj.

- Veprimet përgatitore, në vend që të ezaurojnë çështje të tilla dhe të përgatisin plotësisht çështjen për gjykim, kryhen në mënyrë formale, pra nuk janë efikase.
- Në 5 çështje ka rezultuar se janë vëzhguar 48 seanca gjyqësore, nga të cilat 26 seanca nuk kanë qenë produktive. Pengesë në 26 seanca gjyqësore joproduktive janë bërë: mungesat e palëve; mungesa e gjyqtarës për shkaqe shëndetësore; njoftimi i palëve me shpallje; shtyrja e seancës për të marrë prova; shtyrja e seancave për t'u njohur palët me provat e njëra-tjetrës; shtyrja e seancave për të siguruar palët praninë e avokatëve; shtyrja e seancave për të kryer suksesimin procedural, etj. Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por në procesverbalin e veprimeve përgatitore nuk është shënuar as ora e fillimit dhe as ora e mbarimit të seancës.
- Regjistrimi audio është përdorur në fare pak seanca.

Në lidhje me mangësitë e konstatuara nga Komisioni, subjektit iu kërkuan shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit në prapësime**

Në lidhje me përfundimin e gjykimit tej afateve ligjore të parashikuara, subjekti ka shpjeguar se respektimi i kohës/afateve është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, por qëllimi kryesor në një gjykim është edhe realizimi i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm (neni 14 i Kodit të Procedurës Civile), me cilësi dhe në këtë kontekst, nisur edhe nga një sërë faktorësh të cilët nuk varen tërësisht nga gjykata (si shtyrje seance, marrje apo njohje me prova, harmonizim me institucione të tjera, etj.), ndodhemi para përfundimit të gjykimeve tej afateve.

Në lidhje me çështjet konkrete të trajtuara, për të cilat janë evidentuar vonesa për përfundimin e gjykimit, subjekti ka theksuar edhe faktin që periudha e vlerësimit i takon viteve 2013 – 2016, kohë në të cilën referuar rregullimeve procedurale në fuqi në atë kohë (para ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017) palët në mungesë njoftoheshin për çdo seancë gjyqësore, gjë e cila sillte vështirësi dhe zgjatje të afatit të gjykimit.

Në lidhje me mosdisponimin nga subjekti me vendim apo urdhër formal për caktimin e seancës përgatitore, subjekti ka shpjeguar se: referuar dispozitës ligjore në fuqi për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, neni 158/a i Kodit të Procedurës Civile, ligjvënësi kishte parashikuar “urdhërimin e seancës përgatitore për çdo çështje”, pra seanca përgatitore ishte e detyrueshme për efekt të ligjit dhe jo në vlerësim të gjykatës. Ndërkohë që ligji parashikoi shprehimisht edhe veprimet që kryente gjyqtari me vendim. Në këtë kontekst, nuk rezulton të ishte e detyrueshme vendimmarrja e gjykatës, por thjesht një caktim seance.

Në lidhje me mosmbajtjen nga sekretarja gjyqësore me kompjuter të procesverbaleve të seancave përgatitore, subjekti ka shpjeguar se referuar nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile, mbi veprimet përgatitore, nuk parashikohet dhe trajtohet specifikisht procesverbali përgatitor. Neni 118 i Kodit të Procedurës Civile (më parë dhe ndryshuar në vijim me ligjin nr. 122/2013) mbi aktet procedurale, ka parashikuar se: *“Kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore, si dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance”*. Në këtë dispozitë ka një rregullim të shprehur mbi procesverbalin e mbajtur për seancat gjyqësore dhe veprime gjyqësore jashtë seance. Në lidhje me procesverbalet përgatitore, ato janë mbajtur nga vetë gjyqtari i çështjes.

Subjekti shpjegon se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është praktikë e ndjekur prej vitesh që procesverbalet e veprimeve përgatitore mbahen nga vetë gjyqtarët dhe në mënyrë të përmbledhur. Qëllimi i seancës përgatitore ishte njohja me çështjen nga gjyqtari dhe vetë palët dhe trajtimi sa parashikon neni i sipërcituar. Me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile në vitin 2017, pasqyrimi i seancës përgatitore tashmë mbahet me sekretar gjyqësor.

Në lidhje me konstatimin mbi shtyrje të seancave, si dhe faktit se seancat rezultojnë joproduktive, subjekti ka shpjeguar se gjykata nuk mund të shmangë tërësisht shtyrjen e seancave, pasi referuar nenit 175 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar shtyrja e seancave për shkaqe shëndetësore apo shkaqe të tjera të ligjshme. Interpretimi i këtyre të fundit bëhet rast pas rasti, në varësi të shkakut të paraqitur nga palët.

Shtyrjet e seancave me kërkesë të palëve për mosparaqitje vlerësohen nga gjykata në kuadër të sjelljes së tyre në raport me gjykimin, duke pasur parasysh se pala duhet të dëgjohet nga gjykata mbi pretendimet, të paraqesë prova dhe t'i nënshtrohet procesit të parimit të kontradiktoritetit (neni 14 e vijues dhe neni 18 e vijues i Kodit të Procedurës Civile).

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni vlerëson të pranueshme shpjegimet e subjektit, pasi veprimet procedurale të kryera gjejnë mbështetje në dispozita ligjore. Gjithashtu, mangësitë e konstatuara nga Komisioni nuk kanë sjellë pasoja mbi palët në proces, nuk kanë ndikuar për një gjykim të dobët dhe në raport me ngarkesën e përbulluar prej saj, si dhe nuk cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

## **DENONCIME NGA PUBLIKU**

**Komisioni ka verifikuar 3 denoncime, për të cilat janë administruar dosjet, si vijojnë:**

### **1. Denoncim i shtetasit A. K.**

Denoncuesi ka shpjeguar se ka qenë në cilësinë e paditësit në një proces gjyqësor me objekt “Kundërshtim i veprimeve përmbartimore të shoqërisë së përmbartimit, kundërshtim të vendimit për vlerësimin e sendit të sekuestruar dhe të vendimit për përcaktimin e vlerës së sendeve, etj.”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka depozituar dosjen gjyqësore të çështjes së sipërcituar dhe konstatohet se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.12.2017, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë ...”. Ky vendim është ankimuar nga denoncuesi A. K.

Gjykata e Apelit Tiranë, për këtë çështje, ka vendosur: “Prishjen e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 11.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë/të subjektit të rivlerësimit Enkela Vlora dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate, por me tjetër trup gjykues...”.

### **1.1 Konstatime të Komisionit**

Nga analizimi i akteve ka rezultuar se subjekti ka thirrur një ekspert vlerësues për caktimin e vlerës së pronës, akt të cilin e ka administruar në dosje. Në përfundim të gjykimit, në vendimin e subjektit të rivlerësimit për caktimin e vlerës së sendit, kjo e fundit i është referuar vendimit nr. \*\*, datë 19.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në të cilën është trajtuar e njëjta pronë.

Për këtë dosje u konstatua se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar shkaqet se përse nuk ka marrë për bazë vlerën e sendit referuar aktekspertimit të administruar gjatë gjykimit; si dhe
- subjekti i rivlerësimit, në përcaktimin e vlerës së sendit, nuk është mbështetur në dispozitat e nenit 564 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me procedurën që duhej të ndjekë përmbaruesi gjyqësor për vlerësimin e sendit të sekuestruar.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

## 1.2 Shpjegimet e subjektit

Subjekti ka pretenduar se *kjo çështje nuk ka përfunduar ende, pasi pas prishjes së vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, nuk kemi një vendim përfundimtar që të ketë disponuar ndryshe nga vendimi i sipërcituar i subjektit të rivlerësimit.*

Në lidhje me vlerësimin e sendit objekt gjykimi, referuar dispozitës 564 të Kodit të Procedurës Civile “Vlerësimi i sendit të sekuestruar”, qëllimi/thelbi i kësaj dispozite ka të bëjë me “vlerësimin e sendit të sekuestruar” dhe ky vlerësim të jetë orientuar drejt vlerës reale të pasurisë në treg. Ndërsa akti i ekspertimit i kryer nëpërmjet një eksperti të licencuar është thjesht dhe vetëm mjete mbi të cilin përmbaruesi gjyqësor mund të konkludojë mbi këtë vlerë. Pra, ligjvënësi kërkon një vlerë sendi mbi të cilën do të vijojë procedura dhe parashikon edhe mënyrën për realizimin e saj të qëllimit.

Kjo do të thotë se caktimi i një eksperti të licencuar dhe hartimi prej tij i aktit të ekspertimit nuk është në vetvete qëllimi/thelbi i dispozitës, por nëpërmjet tyre ajo i jep përmbaruesit “mjete” se si mund të realizojë këtë qëllim të vetë dispozitës, vlerësimin e sendit të sekuestruar. Pra duhet të kemi një vlerë sendi të orientuar drejt vlerës reale të pasurisë në treg.

*Në rastin në gjykim gjejmë që përmbaruesi gjyqësor në pikëpamje procedurale ka zbatuar dispozitën e sipërcituar, duke dalë me një vendim nr. \*\*\*, datë 30.11.2016, për përcaktimin e vlerës së sendit, gjë e cila i ka dhënë mundësinë palëve për ta ankimuar.*

*Lidhur me themelin gjejmë që përmbaruesi gjyqësor nuk ka caktuar ekspert vlerësimi, por është bërë duke u bazuar në një vendim gjyqësor të Gjykatës së Apelit Tiranë si vendim i formës së prerë që ka pasur objekt edhe përcaktimin e vlerës së sendit të sekuestruar dhe që ka konkluduar pikërisht mbi një aktekspertim.*

Bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka marrë në shqyrtim vlerën e sendit, në kuadër të ankimit ndaj një vendimi gjykate që ka pasur si objekt kundërshtimin e kësaj vlere, *gjejmë që sendi t’i jetë nënshtruar vlerësimit nga një grup ekspertësh, duke u respektuar çmimet e tregut të lirë (siç citohet në të) dhe në përfundim gjejmë një vlerë të sendit të sekuestruar prej 150.000 euro (kur në shkallë të parë ishte konkluduar 426.000 euro).*

Pra, ka një vlerësim/një vlerë sendi, të bazuar në një aktekspertim, të orientuar nga tregu i lirë dhe të kontrolluar dhe pranuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj të vitit 2015, në një gjykim për vlerësimin e tij, pra nga një organ që qëndron mbi palët.

Këtu theksohet fakti që një send në treg ka një vlerë të përcaktuar/e diktuar nga kosto dhe nga kërkesat në treg (kërkesë - ofertë) dhe në këtë kontekst ajo që mund të ndikojë (brenda një intervali të shkurtër kohor si në rastin në gjykim) është vetëm luhatja e tregut (për sa nuk janë pretenduar dhe provuar ndryshime strukturore apo investime në pronë).



Në të kundërt, përcaktimi pa shkak i vlerave shumë të ndryshme (nga 150.000 euro në 426.000 euro) është larg parimit të sigurisë juridike, duke vendosur kreditorë të ndryshëm në pozita të ndryshme/të pabarabarta përkundrejt të njëjtit send.

Në lidhje me aktekspertimin e hartuar në shtator të vitit 2016 gjatë gjykimit të çështjes nga subjekti i rivlerësimit, kjo e fundit ka pretenduar se nuk rezultojnë shkaqe të tilla të cilat kanë çuar në lëvizje të vlerave të pronës objekt gjykimi në tregun e pasurive të paluajtshme. Sipas ekspertës, vlerësimi i saj ka të bëjë vetëm me atë çka ajo ka konkluduar për sendin objekt gjykimi si vlerë prone në treg dhe jo që kjo vlerë, përkundrejt vlerësimit të vitit 2014 të ekspertëve të caktuar nga gjykata e apelit, ka pësuar luhatje të tillë që justifikon sot (në shtator të vitit 2016) vlerë të ndryshme në tregun e lirë.

- Vlerësimi i bërë nga ekspertja e caktuar nga gjykata në vlerën e dhënë prej saj prej 426.000 euro i referohet vetë sendit dhe karakteristikave të tij në çmuarje të ekspertës vlerësuese dhe jo ndryshimeve të vlerave në tregun e pasurive të paluajtshme për vitet 2014 - 2015 dhe vitin 2016.

- Siç del qartë nga vlera e pronës mes asaj të përcaktuar me vendimin gjyqësor nr. \*\*, datë 19.2.2015, prej 150.000 euro, dhe asaj të përcaktuar nga ekspertët E. L. (privatisht) dhe L. K. (caktuar nga gjykata) (mbi 400.000 euro) për vitin 2016, ka një luhatje tej mase të madhe prej rreth 300.000 euro dhe që, si e tillë, nuk gjen mbështetje në luhatje/ndryshim të tregut të pronave pasuri të paluajtshme të vitit 2016, vlerë të ndryshme në tregun e lirë.

- Në rastin që shqyrtohet, subjekti ka shpjeguar se nuk provohet me prova konkrete nga pala paditëse që prona objekt gjykimi, njësi shërbimi, të ketë pësuar në tregun e lirë një ndryshim/luhatje të tillë nga viti 2014 deri në vitin 2016, për shkak të:

- ndryshimeve thelbësore në strukturën e saj pas vitit 2014 (nuk ka pretendime të tilla);
- investimeve të bëra në këtë pronë pas vitit 2014 (nuk ka pretendime të tilla);
- luhatjeve në treg të pasurive të paluajtshme (të tillë nuk ka edhe sipas ekspertës së caktuar nga gjykata).

Subjekti ka argumentuar se, sa më lart janë arsyetuar shkaqet se përse gjykata nuk ka marrë për bazë vlerën e sendit referuar aktekspertimit të administruar gjatë gjykimit dhe vlera e sendit në rastin në gjykim ishte përcaktuar me vendim gjykate (bazuar në aktekspertim) dhe në një procedurë vlerësimi të këtij sendi.

- Në lidhje me moskryerjen e procedurës së vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 564 të Kodit të Procedurës Civile, subjekti ka pretenduar se kjo procedurë është respektuar, për sa vendimi i përmbaruesit në caktimin e vlerës së sendit (qëllimi i dispozitës) është bazuar në një aktekspertim të marrë nga gjykata e apelit (në një proces ku përmbaruesi ka qenë vetë palë) dhe në vlerë reale të tregut të pronës.

Ajo çka mund të bënte të cënueshëm veprimin e përmbaruesit nga gjykata do të ishte vetëm ndryshimi i vlerës së tregut, përcaktuar me vendim të gjykatës së apelit, për shkak të luhatjes së tregut të pronave, gjë e cila nuk u vërtetua në gjykim.

### **1.3 Vlerësimi i Komisionit**

Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni konstaton se argumentet e subjektit janë bindëse në lidhje me faktin e mosmarrjes për bazë të aktit të ekspertës, për shkak të diferencës

shumë të madhe të vlerës së asetit të konkluduar nga ekspertja (400.000 euro) me çfarë ishte disponuar nga gjykata e apelit për vlerën e të njëjtin aset (vlera 150.000 euro).

Por, Komisioni çmon se subjekti shkaqet për mosmarrjen parasysh të aktit të ekspertes dhe moszbatimin e nenit 545 për përcaktimin e vlerës së sendit duhet t'i kishte parashtruar në vendimin gjyqësor. Në këtë mënyrë do të jepte qartë të gjitha rrethanat dhe shkaqet që e çuan në këtë vendimmarrje. Por pavarësisht këtij fakti, trupi gjykues çmon se mospasqyrimi i shkaqeve për mosmarrjen parasysh të aktit të ekspertes dhe moszbatimin e nenit 545 për përcaktimin e vlerës së sendit edhe në eventualitetin e një mangësie lidhur me këtë kriter mbeten të vetme dhe të pashoqëruar me mangësi të tjera për këtë kriter dhe nuk është e mjaftueshme për t'i çmuar si cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët. Në këtë drejtim, trupit gjykues nuk i rezultuan *indicie* apo elemente në çështje të tjera, për të ngritur dyshime se subjekti ka një mënyrë/model pune të papajtueshëm me pozicionin e tij, as shkelje të respektimit të të drejtave të palëve.

## **2. Denoncim i shtetasit A. E.**

Ky denoncues ka paraqitur ankim për 14 subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilëve edhe subjektin Enkela Vlora, duke ngritur pretendime se ky subjekt është pjesë e një grupi të strukturuar kriminal.

Denoncuesi ka ngritur këto pretendime:

- Subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë dy vendime me të njëjtën përmbajtje dhe ekstremite: vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2004, për shitjen e 50% të kuotave të shoqërisë "A" sh.p.k., me ortak shtetasin A. E.; dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2005. Denoncuesi pretendon që nuk ka shitur asnjëherë kuota por janë dokumente të manipuluar. Falsifikimi qëndron në ndryshimin e numrit të fundit të vitit një herë 4 dhe një herë 5, shkruar me shkrim dore, pra viti 2004 dhe viti 2005, fakt i provuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim mbështetur në dokumente të falsifikuara, për të cilin ka depozituar edhe një kallëzim penal në ngarkim të kësaj gjyqtareje.

Në lidhje me pretendimet e denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

### **2.1 Prapësimet e subjektit**

Në lidhje me pretendimet e këtij denoncuesi, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjerave, se ky shtetas për pretendimet e ngritura në këtë denoncim ka bërë, gjithashtu, një kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit në lidhje me falsifikim dokumentesh etj.

Subjekti shpjegon se: *"Nga hetimet e bëra nga organi i akuzës nuk ka dalë asnjë rrethanë e tillë që unë si gjyqtare të jem 'pjesë e ndonjë grupi kriminal', të kem falsifikuar akte apo të kem pasur ndonjë qëllim në kundërshtim me detyrën në lidhje me depozitimin e bërë"*.

Aktet e marra në shqyrtim dhe të depozituara nga gjykata kanë qenë të gjitha në formën e kërkuar nga ligji i kohës për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (referuar llojit, përmbajtjes, noterizimit të tyre (kërkesa, vendimi, statuti dhe kontrata e shitjes, kjo me akt noterial).

Janë marrë në shqyrtim aktet në tërësi dhe është konkluduar vendimi i ndodhur në praktikën e gjykatës, i cili mban datën 21.9.2005 dhe është depozituar në librin e depozitimeve të gjykatës

në datën 3.10.2005, me nr. \*\*\* dhe në këtë kontekst çdo person i interesuar mund të njihej me të dhe të tërheq kopje.

Mbi bazën e kallëzimeve të këtij denoncuesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2017, ka vendosur rrëzimin e ankimit të z. A. E., me objekt “Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Elbasan me nr. \*\*\* të vitit 2015, për vendimin e pushimit të procedimit penal dhe shfuqizimin e vendimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016, për pushimin e pjesshëm të procedimit penal”.

Denoncuesi ka depozituar ankim në KLD, ku është vendosur arkivimi në datën 29.12.2017.

## **2.2 Vlerësimi i Komisionit**

Pavarësisht pretendimeve të subjektit, në kushtet kur çështja objekt verifikimi i përket vitit 2005, referuar pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “*Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga data 1.1.2006 e në vazhdim ...*”, Komisioni vlerësoi se mangësitë e pretenduara nga denoncuesi në këtë çështje nuk mund të penalizojnë subjektin e rivlerësimit.

## **3. Denoncim i shtetases A. S.**

Denoncuesja A. S. është përfshirë në një proces gjyqësor si palë e paditur, me objekt “lirim dhe dorëzim sendi”, shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora.

Nga verifikimi i akteve të dosjes u konstatua se:

a. Me gjithë kompleksitetin që ka paraqitur çështja, kërkesat e shumta procedurale të palëve të përfshira në proces dhe emërimin e disa ekspertëve vlerësues, çështja ka zgjatur më shumë se 3 vjet (periudha 7.4.2017 – 24.6.2020), afat i cili është në shkelje të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

b. Subjekti i rivlerësimit ka pranuar kërkesën e palës paditëse për ndryshimin e shkakut ligjor të padisë, mbështetur në nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile:

- nga aktet në dosje ka rezultuar se kërkesa e paditësit nuk është paraqitur në seancë përgatitore dhe ky i fundit ka ndryshuar shkakun ligjor dhe objektin e saj;
- në disa nga procesverbalet e seancave gjyqësore, gjykata ka referuar se nuk mund të bëhet regjistrimi audio i seancës, pasi sallat janë të zëna;
- ky fakt është ngritur edhe nga denoncuesi, ku rezulton se subjekti nuk i ka mbajtur seancat me regjistrim audio.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kërkuan shpjegime.

### **3.1 Prapësimet e subjektit**

Subjekti ka pranuar se kohëzgjatja e procesit ka zgjatur më shumë se 3 vjet, por referuar dosjes gjyqësore, rrethanave të paraqitura dhe të trajtuara në të, efektet e ardhura nga COVID-19, njoftimit të palëve në vijimësi (referuar Kodit të Procedurës Civile para ndryshimeve të ligjit nr. 38/2017), gjykimi paraqitet në kushtet e pamundësisë objektive që të respektohej afati standard (kjo është shumë e evidente sipas subjektit). Gjatë një gjykimi, qëllimi parësor është zgjidhja e konfliktit dhe dhënia zgjidhje e të gjitha kërkesave të palëve, më pas është rëndësia e një afati të arsyeshëm ligjor.

Në lidhje me konstatimin se ishte pranuar ndryshimi i shkakut ligjor të padisë në seancë gjyqësore, subjekti ka pretenduar se *në kohën gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje nuk kishin filluar efektet ligjore të ligjit nr. 38/2017. Për pasojë, me dispozitat e vjetra të Kodit të Procedurës Civile “Paditësi gjatë hetimit gjyqësor kishte të drejtë të ndryshonte shkakun ligjor të padisë. Ai, edhe pa e ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë”*.

Subjekti, në lidhje me pretendimin se seancat janë zhvilluar pa regjistrim audio, e ka pranuar këtë fakt, duke argumentuar se ishte pamundësi objektive, pasi Gjykata e Rrethit Tiranë ka pasur shumë ngarkesë pune dhe mungesë sallash. Bazuar në urdhrin e kryetarit (depozituar në prapësime) ka rezultuar se subjekti ka pasur të drejtë të zhvillonte seanca gjyqësore në sallat me regjistrim audio, vetëm një ditë në javë (ditën e premte) disa orë.

Subjekti ka shpjeguar se në mungesë të regjistrimeve *audio* janë mbajtur rregullisht procesverbalet e seancave gjyqësore, ku është dokumentuar mbarëvajtja e procesit të zhvilluar prej saj, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga çdo palë e interesuar.

### **3.2 Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni arsyeton se afati i shqyrtimit të çështjes është tejet i gjatë, por në raport me ngarkesën e subjektit në këtë periudhë, kompleksitetin e çështjes në fjalë ku ishin disa palë ndërgjyqëse, faktit që janë caktuar dhe larguar disa ekspertë, dhe kërkesat e vazhdueshme të palëve, u vlerësua jo me peshë në vlerësimin tërësor dhe nuk cenon aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në lidhje me konstatimet e tjera të Komisionit, shpjegimet e subjektit janë në nivel të pranueshëm dhe bindës, për sa janë argumentuar prej saj.

**4. Komisioni ka hetuar në lidhje me një artikull të bërë publik në media**, për një dosje gjyqësore, publikuar në portalin “T”. Nisur nga ky fakt, duke e vlerësuar si një çështje që kishte marrë vëmendjen e publikut, Komisioni administroi dosjen gjyqësore për të verifikuar pretendimet e ngritura në këtë denoncim, të cilat lidhen kryesisht me themelin e çështjes objekt gjykimi. Paditësja ka pretenduar mbi pavlefshmëri testamenti, duke parashtruar edhe faktet në gjykim.

Komisioni, nga analizimi i dosjes, ka konstatuar se:

- Dy procesverbale të seancave gjyqësore janë mbajtur nga subjekti i rivlerësimit me shkrim dore.
- Gjykimi ka zgjatur 9 muaj, në shkelje të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar në germën “e”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.
- Seancat gjyqësore janë mbajtur pa regjistrim audio.

Në lidhje me këto konstatime subjektit iu kërkuan shpjegime.

#### **4.1 Prapësimet e subjektit**

Procesverbalet e seancave përgatitore janë mbajtur nga vetë gjyqtari, duke pasqyruar në mënyrë të përmbledhur sa është zhvilluar. Në vijim është kaluar në seancë gjyqësore. Në lidhje me afatin standard të gjykimit kanë ndikuar edhe shtyrjet e bëra nga palët, si dhe fakti që periudha korrik – gusht është leje vjetore.

Kjo çështje nuk ka pasur regjistrime audio, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, veçanërisht në periudhën 2013 – 2015, kishte pamundësi objektive për regjistrime audio të seancave, pasi gjyqtarët kishin sallë me regjistrim audio një herë në javë për pak orë.

#### **4.2 Vlerësimi i Komisionit**

Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni konstaton se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe është apeli që gjykon vendimmarrjen e gjyqtarës së shkallës së parë. Komisioni nuk ka kompetencë shqyrtimi lidhur me pretendime të tilla.

Shkelja e afatit standard të gjykimit me 3 muaj, duke marrë në konsideratë shkaqet për shtyrjet e seancave bazuar në kërkesat e palëve, kompleksitetin e çështjes, si dhe ngarkesën e lartë të çështjeve, janë shkaqe të arsyeshme që kanë sjellë zgjatjen e gjykimit përtej standardit.

Në lidhje me seancat e zhvilluara pa regjistrim audio, argumentet e subjektit qëndrojnë, pasi Gjykata e Rrethit Tiranë është gjykata me ngarkesën më të lartë të çështjeve dhe ka një numër të kufizuar sallash, por këto nuk duhet të shërbejnë si justifikim për mosregjistrim audio të seancave.

#### **Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias<sup>57</sup> dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>58</sup>, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të germës E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se subjekti i rivlerësimit:

- a) ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016;
- b) ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- c) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- d) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

#### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar *i aftë* profesionalisht, për shkak se ka arritur

<sup>57</sup>Shihni opinionin e Venecias, me nr. 824/2015.

<sup>58</sup>Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Enkela Vlora ka plotësuar së bashku kushtet vijuese:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Enkela Vlora (Bajo), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 10.6.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**  
**Relatore**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*

